



UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE

FAKULTETI JURIDIK

MASTER DREJTIMI PENAL

PUNIM I MAGJISTRATURËS

**TEMA:“ DËNIMI ME GJOBË NË KODIN PENAL AKTUAL TË
RMV-SË, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË TERRITORIN E
GJYKATËS THEMELORE TË GOSTIVARIT PËR PERIUDHËN
2009-2013“**

MENTORI

Prof Dr Ismail Zejneli

KANDIDATI

Shkëlzen Selmani

Tetove, 2020

DEKLARATË

Unë *Shkëlzen Selmani* me përgjegjësi të plotë deklaroj se jam autor origjinal i këtij disertacioni dhe puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve .

Tetovë,

2020

.....

FALËNDERIM

Falënderimi më i madh i takon ALL-LLAHUT të madhëruar që së pari më ka dhënë shëndet dhe pastaj të gjitha mundësit tjera për të studiuar dhe arritur gjerë këtu. Përgatitja dhe finalizimi i këtij projekti kaq të rëndësishëm në jetën profesionale dhe akademike ka gjetur mbështetjen, përkrahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të rëndësishëm në jetën time, të cilët gjej rastin t'i falënderoj përzemërsisht. Mirënjohje dhe falënderim për udhëheqësin shkencor Prof Dr Ismail Zejneli për ndihmën që më ka dhënë gjatë strukturimit dhe shkrimit të temës dhe për mbështetjen profesionale, akademike, psikologjike, dhe shpirtërore në hartimin dhe përfundimin e këtij punimi. Dhe gjithë profesorëve të tjerë, stafin mbështetës të fakultetit për kontributin e tyre të dhenë gjatë gjithë kohës së studimeve dhe punimit të tezës së magjistraturës. Falënderimet më të përzemërta i takojnë familjes sime, në veçanti prindërve të mijë të cilët në radhë të parë më dhanë edukimin, mbështetjen dhe inkurajimin për të arritur objektivat jetësore.

HYRJE

Objekt trajtimi në këtë punim do të jetë dënimi me gjobë si sanksion penal, me theks të veçantë sipas të drejtës penale në RMV në kontekstin historik dhe atë aktual, ilustruar me shembuj dhe analiza nga Gjykata Themelore e Gostivarit dhe e përcaktuar pikërisht për periudhën 2009-2013. Gjykojmë se brenda kësaj periudhe do të kemi mundësi të gjejmë materialin nga punonjësit në gjykatë, në sektorin e dënimeve me gjobë dhe të dhënat e sakta dhe mbi to të ndërtojmë pjesën empirike të punimit.

Çështje kryesore e së drejtës penale të çdo vendi janë sanksionet penale. Në të drejtën penale masat të cilat zbatohen ndaj kryerësve të veprave penale quhen sanksione penale. Me vetë faktin e kryerjes së një vepre penale shtrohet çështja e sanksionit ndaj kruesve të veprës penale. Sanksionet definojnë si mjete që i ndërmerr shteti në kohërat më të hershme edhe vetë shoqëria ndaj delinkuentit. Sanksionet penale janë preokupim kryesor i së drejtës penale nga fakti se në të gjitha rastet kur personi i caktuar kryen vepër të rrezikshme, e cila është e kundërligjshme dhe e përcaktuar si vepër penale është e domosdoshme që shoqëria ndaj kryerësit të veprës penale të ndërmerr ndonjë masë që kryerësi në të ardhmen mos të kryej vepër penale. Në të drejtën penale masat që ndërmerren ndaj kryerësit të veprës penale quhen sanksione penale. Shteti që pretendon të jetë demokratik dhe human ndaj qytetarëve të vet për parandalimin dhe çrrënjosjen e kriminalitetit krahas sanksioneve penale duhet të disponoj edhe me masa të ndryshme siç janë: ngritja e nivelit të arsimit, kulturës dhe vetëdijes për respektimin e ligjit, të lirive dhe barazisë së të gjithë qytetarëve në të gjitha fushat e jetës.

Çdo sanksion i shqiptuar kryerësit të veprës penale ngërthen në vete dy elementet të rëndësishme edhe atë pasojën juridike ndaj kryerësit për veprën penale të kryer, sanksionin penal masë kjo që i shqiptohet kryerësit të veprës penale, apo kufizimin e disa lirive dhe të drejtave të kryerësit. Meqë sanksionet penale janë çështje themelore të së drejtës penale dhe janë në epiqendër të saj këto janë edhe pjesa më dinamike e kësaj dege të drejtësisë. Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurë të përcaktuar me ligj ndaj kryerësit të veprës penale, me qëllim të

mbrojtjes të shoqërisë nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në tërheqjen e vërejtjes kryerësit se do ti merren apo kufizohen liritë dhe të drejtat nëse sërish kryen veprë penale.

Dimë, se kriminalitetit nuk është dukuri e mirë, dhe njihet si dukuri e kundërligjshme dhe shoqërisht e rrezikshme është dashur dhe duhet t'i kundërvihen institucionet kompetente në mënyrë sa më efektive, me qëllim që kryerësit penalisht përgjegjës t'i shqiptohet dënimi adekuat, për mes të cilit do të arrihet efekti i duhur, dhe personi i dënuar pas mbajtjes së dënimit (natyrisht duke përdorur mjete dhe metoda për tretman sa më adekuat) që i dënuari pas mbajtjes së dënimit, të arrij të risocializohet në mënyrë sa më të efektshme dhe të bëhet person i përshtatshëm dhe i dobishëm për shoqërinë dhe ambientin ku jeton dhe vepron. Prandaj, ndëshkimi në formën e një gjobe është ndryshe nga pagesa e një takse, pavarësisht se të dy përfshijnë pagesë për shtetin. Gjithashtu, burgosja është në kontrast me format e tjera të paraburgimit, siç është karantina, apo izolimi për çrregullime psikiatrike.¹ Të dënuarit me gjobë, dënimi i tillë është një formë e sanksion penal për dalim nga institutet tjera të së drejtës penale ka arritur të evoluojë në masë të konsiderueshme, duke u përsosur vazhdimisht, e gjithë kjo me qëllim të përshtatjes së rrethanave të tjera dhe për ta arritur efektin e tij. Dënimi me gjobë bën pjesë në llojet e dënimeve pasurore. Me anë të këtij dënimi me gjobë, autori i veprës penale detyrohet që brenda afatit të caktuar të paguajë një shumë të hollash në dobi të shtetit. Gjoha është një formë e dënimit në pasuri në para, që konsiston në imponimin e të dënuarit me detyrim penal dhe juridik për të paguar shumë të caktuar të hollash shtetit për veprën penale të kryer. Karakteri i saj si ndëshkim publik-juridik, detyrimi për të paguar një shumë parash në favor të shtetit, e dallon atë nga detyrimet civile të dënuarit kundrejt shtetit. Për këtë, i dënuari nuk mund të kompensohet, të mbartet, ose merret nga tjetri, ose të trashëgohet. Për të sqaruar më së miri konceptin e dënimit me gjobë është dhënë nga Kodi Penal, i cili në nenin 34 të tij parashikohet se: — Dënimi me gjobë konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shumë të hollash brenda kufijve të parashikuar në ligj. Dënimi me gjobë jepet për personat që kryejnë krim ose kundërvajtje penale”.²

¹ Shih Duff, A. and D. Garland. 1994. —Introduction: Thinking About Punishment. || Pp. 1–43 in A Reader on Punishment, edited by Antony Duff and David Garland. Oxford, England: Oxford University Press., fq 13

² Shih Vllado Kambovski —E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Botimi i dytë, SHB —Furjan Ism|| Shkup, 2007, fq 485

Së këndejmi edhe e drejta penale shqiptare ka qenë kompatible duke i inkorporuar këto evoluime në kuadër të legjislacionit penal.

Punimi me titull “ **DËNIMI ME GJOBË NË KODIN PENAL ALTUAL TË RMV-SË, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE TË GOSTIVARIT PËR PERIUDHËN 2009-2013**“ ka gjithsej pesë kapituj, ku në pjesën e parë të titulluar historiku i dënimeve me gjobë dhe trajtimi juridik i tij, vështrime të përgjithshme mbi dënimin, bëhet fjalë për nocionin e dënimit, qëllimi dhe karakteristikat dhe elementet e dënimit, kurse kapitulli i dytë të titulluar dënimi me gjobë në Kodin Penal aktual të RMV-së do të trajtohen të gjitha llojet e dënimeve dhe lartësia e dënimeve, afatet e përmbarimet, kapitulli i tretë i titulluar si disa aspekte kriminologjike të dënimit më gjobë, ndërsa në kapitullin e katërt do të analizojmë dënimet me gjobë në mënyrë krahasuese në disa kode penale të shteteve tona përreth në Kosovë dhe Shqipëri, dhe të kapitulli i fundit do të trajtohen dënimet me gjobe dhe lartësia e tyre te personat fizik dhe juridik.

Me rastin e përgatitjes së këtij punimi jam shërbyer me metoda duke filluar nga ajo historike, pastaj aktuale si dhe në disa aspekte në plan komparativ.

LËNDA E HULUMTIMIT

Nisura nga e dhëna e përgjithshme se kriminaliteti si një e keqe e madhe e ka përcjellur shoqërinë në të gjitha fazat e zhvillimit të saj, duke i shkaktuar dëme të mëdha. Sanksionet penale në sistemet juridike në përmasa shtetërore dhe ndërshtetërore janë pjesa me dinamike e zhvillimit të së drejtës penale. Punimi me titull “ **DËNIMI ME GJOBË NË KODIN PENAL ALTUAL TË RMV-SË, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE TË GOSTIVARIT PËR PERIUDHËN 2009-2013**“ synon të jetë gjithëpërfshirës, i strukturuar, duke ruajtur objektin kryesor të studimit, atë të dënimeve me gjobë.

Historiku dhe zhvillimi i të drejtës penale është vetë historiku i zhvillimit të sanksioneve penale. Është kështu nga fakti se ndryshimet më të mëdha në të drejtën penale gjatë historikut të zhvillimit të sajë janë bërë mu në sistemin e sanksioneve penale.³

³ Ukaj B, *Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë*, Prishtinë f. q. 13/14

Sistemi i sanksioneve penale në të gjitha shtetet e botës, është pika kryesore e preokupimit të teoriticianteve juridiko penal dhe praktikes gjyqësore, por edhe çështje interesimi i organeve shtetërore dhe jo shtetërore. Dënimet me gjobë janë një nder pjesët më të rëndësishme të së drejtës penale ngase kushtet për shqiptimin e tyre dhe mënyra e shqiptimit të tyre përcaktojnë pothuajse të gjitha zgjidhjet thelbësore në të drejtën penale.

Është aktuale tema e dënimeve me gjobë andaj dhe rëndësia e dënimi me gjobë në të drejtën penale dhe në shoqërinë tonë, është një nxitje që të përcaktohem në studimin e dënimit përmes këtij punimi me ç' rast do të paraqesë nocionin, historikun, karakteristikat, dhe llojet e dënimeve përgjithësisht por me theks të veçante ato që janë aplikuar dhe aplikohen në vendin tonë, respektivisht ne Republikën e Maqedonisë së Veriut ku jetojnë një pjesë e madhe e shqiptarëve dhe jo për politikë ditore por do analizojmë në përqindje dhe nacionalitetin e të dënuarve ku sipas të dhënave joformale del se më të falur janë maqedonasit në raport me shqiptarët, dhe se shqiptarëve u shqiptohen dënime drakonike me para për thyerje ligji!

Dënimi me gjobë është pjesa më e rëndësishme dhe aktuale e të drejtës penale, ngase të gjitha pjesët e tjera në mënyrë të drejtpërdrejt ose jot ë drejtpërdrejt janë të ndërlidhura me dënimin si sanksion penal. Rëndësia e tij shihet edhe për faktin se aj është mjet i rëndësishëm në duart e shtetit me ndihmën e të cilit shteti lufton format e rrezikshme të kriminalitetit dhe mbron vlerat më vitale te individit dhe shoqërisë ne përgjithësi. Pikërisht mbi këtë objekt studimit, dhe për ketë arsye jetike studimore, edhe studimi i dënimit me gjobë paraqet një interes të veçantë në shoqërinë tonë e cila për nga niveli është e përafërt me shtetet tonë përreth. Dënimi me gjobë është mjet i rëndësishëm në duart e organeve kompetente për të luftuar kriminalitetin dhe të pasqyroj të dhënë se moszbatimi i tyre i përshtatshëm kushtëzon vete gjyqin, hakmarrjen, por dhe të vërtetoj faktin se zbatimi i përshtatshëm dhe i shpejt është me rendësi në luftimin e kriminalitetit dhe mjet i fundit ne mbrojtjen e vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë në përgjithësi.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Gjatë punimit “ **DËNIMI ME GJOBË NË KODIN PENAL ALTUAL TË RMV-SË, ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE TË GOSTIVARIT PËR PERIUdhËN 2009-2013**“, si qëllim kryesor dhe në funksion të arritjes së objektivave të studimit, punimi është organizuar duke gërshetuar aspektin teorik, praktik, historik dhe atë krahasimor. E para duke shfrytëzuar një literaturë për paracaktuar me ndihmën e mentorin, dhe profesorëve që ligjërojnë lëndën e Të drejtës penale, në aspektin praktik do të vizitojmë Gjykatën Themelore të Gostivarit të cilës zyrtarit do ti dërgojmë një seri kërkesash për hir të punimit dhe sigurimi të informatave të cilat do të na duhen në pjesën empirike të punimit, historik duke bërë një prerje të hollë informacionit të cilin e marrim nga kanuni jonë, nga e drejta zakonore shqiptare e dënimit, dhe në fund në aspekt krahasimtar do të analizojmë dënimin më gjobë në Kosovë dhe Shqipëri.

METODAT E PUNËS SHKENCORE

Një ndihmesë të madhe shkencore në këtë drejtim ka dhënë përdorimi i metodave klasike të studimit krahasues, historik, analizës shkencore, sintezës, deduksionit, induksionit, të cilat përfshijnë rrugët, mënyrat, rregullat, procedurat bazë për realizimin e qëllimit studimor mbi peshën e dënimit më gjobë. Këto metoda, cilat në rastin e punimit tonë janë disa, në tërësinë e tyre përbëjnë metodologjinë e shfrytëzuar në hulumtimin shkencor brenda punimi modest në nivel të magjistraturës. Të dy aspektet e metodologjisë, si ajo e përgjithshme, e cila studion parimet dhe proceset metodike të përbashkëta për të gjitha shkencat, ashtu edhe ajo e veçantë, që ka të bëjë me sfera të caktuara të shkencës juridike, specifike, e cila studion proceset metodike karakteristike për disiplinën e kësaj të fundit. Analiza përfaqëson ndarjen e objektit që studiohet në pjesët e tij përbërëse. konsiderohet si një nga metodat më të rëndësishme të hulumtimit logjik shkencor, e cila gjithmonë është e pandarë me metodën e sintezës, e cila përfaqëson një bashkim përmbledhës të elementëve të një objekti studimi. Ajo shkrin idetë e veçanta në një ide të re, përmbledhëse, përgjithësuese.

Analiza dhe sinteza janë në unitet me njëra tjetrën dhe ndihmojnë në nxjerrjen e rezultateve nga terreni më saktësisht në Gjykata e paracaktuar në fillim të punimin dhe e përcaktuar saktë brenda kohës 2009-2013. Pa analizë nuk mund të ketë sintezë, ndërsa pa

sintezë analiza nuk do të kishte kuptim. Qëllimi i kërkimit shkencor është që të arrihen rezultatet dhe përfundimet, me të cilat zbulohen apo verifikohen ligjshmëritë, rregullat, teoritë, ligjet, sistemet e dënimeve penale, ose analizë teorike, praktike dhe empirike e një problemi të panjohur, apo pak të njohur më parë. Metoda e analizimit të hollësishëm të kuadrit ligjor brenda kësaj gjykate, i cili ka për objekt aspekte të ndryshme të dënimit penal, dhe të mbledhjes së të dhënave përmes observimit, të vështrimit kritik të literaturës dhe jurisprudencës, është e pranishme në pjesën më të madhe të punimit. E njëjta do të jepet në formë tabelorë dhe do të kemi përshkrim të të dhënave.

HIPOTEZAT

Gjatë punimit do mundohemi tu japim përgjigje disa hipotezave:

1. Shqiptimi i dënimit me gjobë në baze të ligjit aktual të RMV-së
2. Dënimi me gjobë në territorin e komunës së Gostivarit, në Gjykatën themelore të Gostivarit
3. Dënimi me gjobë në baze të veprave penale dhe veprave kundërvajtës në varësi të rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

STRUKTURA E PUNIMIT

DEKLARATË

FALËNDERIM

HYRJE

LËNDA EHULUMTIMIT

METODAT E PUNËS SHKENCORE

HIPOTEZAT

STRUKTURA E PUNIMIT

KAPITULLI I

- 1.HISTORIKU I DËNIMIT ME GJOBË
2. TRAJTIMI JURIDIK I DËNIMIT ME GJOBË NË KUADËR TË LEGJISLACIONIT TË RMV-SË
3. NDRYSHIMET DHE SFIDAT E DËNIMIT ME GJOBË GJATË SHEKULLIT XXI

KAPITULLI II

DËNIMI ME GJOBË NË KODIN PENAL TË RMV-SË

- 1.PËRKUFIZIMI I DËNIMIT
- 2.LARTËSIA E DËNIMIT
- 2.3DËNIMIMEGJOBË
- 2.4 AFATET E PËRMBUSHJES SË DËNIMIT ME GJOBË
- 2.5 PËRMBARIMI I DËNIMIT ME GJOBË
- 2.6 KONVERTIMI I DËNIMIT ME GJOBË NË DENIM ME BURGIM DHE DËNIM ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

KAPITULLI III

3.1 DISA ASPEKTE KRIMINOLOGJIKE TË DËNIMIT ME GJOBË

3.1.1DISA ASPEKTE KRIMINOLOGJIKE TË SHQIPTIMI T TË DËNIMIT MË JOBË NË GJYKATËN THEMELORE TË GOSTIVARIT NË PERIUDHËN 200-2013

3.2 ECURIA E DENIMIT MË GJOBË

3.4 DINAMIKA E SHQIPTIMIT TË DËNIMIT ME GJOBË

3.5 MOSHA E TË DËNUARVEMEGJOBË

3.6 GJINIA ETËDËNUARVE

3.7 NACIONALITET I TË DËNUARVE ME GJOBË

3.8VENDI DHE KOHA E KRYERJES SË VEPRËS PENALE DISA ASPEKTE ETIOLOGJIKE PËR PERSONAT E DËNUARMEGJOBË

DËNIMI ME GJOBË I PËRCAKTUAR NË MËNYRË KRAHASUESE NË DISA KODE PENALE

4.1KOSOVË

DËNIMIMEGJOBË

GJYSMËLIRIA

DËNIMET PLOTËSUESE

4.2.SHQIPËRI

KAPITULLIV

DËNIMI ME GJOBË DHE LARTËSIA E DËNIMIT TË TIJ NDAJ PERSONAVE
FIZIK PERSPEKTIVA E DËNIMIT ME GJOBË

5.1 PJESA EMPIRIKE E STUDIMIT
PËRFUNDIM

BIBLIOGRAFIA

PËRMBAJTJA:

KAPITULLI I

1.HISTORIKU I DËNIMIT ME GJOBË

Në aspektin e historisë së dënimit me gjobë dhe në aspektin e evolucionit historik është më i vjetër se dënimi i njohur si dënim me burgim. Në Itali, më saktë në Romën e lashtë dënimi me gjobë, ka qenë një dënim i aplikueshëm edhe për veprat më të rënda penale. Në shekullin e VI popujt gjerman aplikuan dy lloje dënimesh me gjobë, njëri shkonte në dobi të të dëmtuarit, kurse tjetri shkonte në dobi të shtetit. Një sistem juridik i cili duke qenë si i tillë u mbart dhe u bë më i aplikueshëm në periudhën e hershme të mesjetës, në të cilën dënimi me gjobë u bë dominant edhe për veprën penale të vrasjes.⁴ Në shekullin e IV ky sistem pësoi ndryshime, duke i dhënë prioritet pagesës në favor të shtetit. I dëmtuari nuk përfitonte asgjë nga dënimi me gjobë, duke mos qenë i interesuar për ndjekje të autorit të veprës penale. Prandaj ushtrimi i ndjekjes penale duhet të ushtrohej nga shteti. Procedura inkuizitore kontribuoi në përforcimin e aplikimit dënimeve trupore dhe atij me vdekje. Në këtë drejtim, vlen të përmendet se ky sistem evoluoi drejt aplikimit të dënimit me burg nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shek. XIX. Përparësitë negative që ofronte ky sistem i la hapësirë dënimit me gjobë. Pas Luftës së Dytë Botërore, kjo formë dënimi ka filluar të aplikohet në përmasa më të gjëra. Për shkak të tipareve dhe përparësive, në legjislacionet penale bashkëkohore, dënimi me gjobë gjithnjë e më tepër është duke u afirmuar dhe duke u masivizuar.

Gjatë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore, lufta kundër kriminalitetit është zhvilluar me mjete dhe metoda të ndryshme të cilat pak a shumë kanë kontribuar në mbrojtjen e të mirave të shoqërisë nga takimet dhe shkeljet e ndryshme. Këto mjete dhe metoda kanë qenë të llojllojshme, varësisht nga shkalla e zhvillimit të shoqërisë së caktuar dhe nga organizimi dhe rregullimi shtetëror dhe juridik I një shoqërie.

Gjate gjithë asaj kohe çdo mjet apo metodë e cila pak a shumë ka ndihmuar në mbrojtje e shoqërisë nga çdo lloj kriminaliteti ka qenë e kapshëm marrë parasysh faktin e mosfunksionim të ligjit adekuat për çdo lloj vepre penale , mungesa e institucioneve përkatëse në luftë kundër kriminalitetit.

⁴ Shih <http://ëëë.slv.esnik.com.mk/Issues/2E4F0BC4EF9FC2438C08C160CBAAEA67F.pdf>, nenin 34 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Gjatë një periudhe të gjatë kohore si mjete dhe metoda të vetme të luftës kundër kriminalitetit kanë dominuar dënimet fizike dhe trupore, tortura fizike dhe psikike si dhe dënimet me vdekje. Si dënime kryesore kanë qenë dënimi me vdekje ku bëjnë pjesë: hedhja e personave të dënuar në zjarr, djegia, ngulja në hu, mbytja në ujë, prerja e kokës, futja në dhe për së gjalli, hedhja në turr të druve dhe hedhja në katran me valë. Po ashtu janë aplikuar dënimet dhe torturat fizike në fazën e reagimit publik. Ndër dënimet trupore përmenden: prerja e hundës, prerja e veshëve, prerja e gjuhës dhe rrahja me kamxhik.

Si dënime tjera kanë qenë: degradimet morale dhe dëbimi.

Këto dënime krahasuar me dënimet e sotme kanë qenë më të vrazhda thënë jo njerëzore, sot kemi rastin ku shumë akte dhe shumë konventa ndërkombëtare që ashpër kundërshtojnë këto lloje dënimesh, gjithmonë marrë parasysh faktin se me dënime të tilla ndaj kryerësit të veprës penale nuk do arrihet deri në risocializimin dhe riedukimin e tij.

Këto dënime kanë dominuar gjatë shekullit 19 pjesë nga këto dënime kanë qenë të aplikuara gjatë shekullit 20 nga këto shtete Angli Amerikë Minesota.

Kundërshtoj ashpër aplikimin e atyre dënimeve ndaj kryerësve të veprave penale ,sanksionet penale definoohen si mjete e jo si hakmarrje ndaj kryerësve të veprave penale.

Aplikimi i dënimeve të sotme dukshëm ndihmon në shkallen e rehabilitimit dhe risocializimit.

Në zhvillimin historik të dënimit me gjobë, dënimi me gjobë është më i vjetër se dënimi i të privuarit nga liria. Në shekullin VI të popujt gjerman u paraqiten dy lloje dënimesh në të holla: njëri shkonte në dobi të të dëmtuarit, kurse tjetri në dobi të shtetit. Sistemi i tillë u mbajt edhe në periudhën e hershme të mesjetës ku dënimi me gjobë ka qenë dominant edhe për vepra të vrasjes që i jepte sistemit të dënimit formën më humane në krahasim me periudhën e mëvonshme, të zbatimit të dënimit me vdekje dhe dënimit trupor.

Dënimi i sotëm me gjobë si dënim juridiko-publik e ka origjinën nga ky dënim ose pjesë e dënimit me gjobë që e kanë paguar në dobi të shtetit.

Me kohë qeveritarë krijuan dobinë e madhe personale dhe shtetërore që mund ta nxiste të dëmtuarin nga konkurrenca e pagesës së dënimit me të holla.

Ndryshimi i tillë i krijuar që ndodhi në shekullin XIV shkaktoi pasoja të mëdha mbi sistemin penalo-juridik: i dëmtuari i cili nuk fitonte asgjë nga dënimi me gjobë nuk ishte i interesuar për ndjekje të kryerësit, kështu që shteti vet duhet ta merrte në dorë

funksionin e ndjekjes. Kjo më tutje shkaktoi ndryshime në karakterin e procedurës penale, ku gjithnjë e më shumë dobësoheshin elementet akuzuese që u zëvendësuan me elementet inkuizitore.

Te procedura inkuizitore nuk ekzistojnë palët në procedurë, pas kryerjes së veprës penale fillon ndjekja. Kolegji gjyqësor pas vërtetimit të fakteve dhe mbledhjes së provave adekuate mban seancë me dyer të hapura, në këtë procedurë e pranishme është edhe zbatimi i torturës dhe frikës për zbardhjen e të vërtetës. Do të theksoja anët negative dhe pozitive të këtij tipi inkuizitor.

Ana negative ka të bëjë me zbatimin e çdo lloj torture apo degradimi moral ndaj kryerësve të veprave penale, gjë që në kohërat e hershme e lejuar edhe në procedurë tashme e ndaluar rreptësisht, ana pozitive pasi që ky tip gjithë çka fillon ex officio sipas detyrës zyrtare rast që gjykata duhet të jetë më aktive në zhvillimin e gjithë procedurës.

Procedura inkuizitore kontribuoi në përforcimin e pozicionit të dënimeve juridiko-publike me çka u krijuan kushte për afirmimin e dënimit me vdekje dhe të dënimeve trupore si dënime të rregullta edhe për dënimet më të lehta.

Procedura akuzatore dukshëm ndikon në pozicionin e të dëmtuarit në procedurë penale ku gjithë procedura nuk zhvillohet ex officio, po nga ana e paditësit me ofrimin e provave adekuate për rastin konkret, mendoj procedurë e tillë dhe publike dhe mos zbatimi i torturave të ndryshme në zbardhjen e së vërtetës dhe ana tjetër negative rast ku nuk mbrohet vetëm i pandehuri i pafajshëm por edhe ai fajtor.

Gjitha këto tendenca në afirmimin e një modeli adekuat të procedurës penale anashkalimin e çdo lloj torture në procedurë por edhe tendencave tjera ligjvënëse në gjurmimin e veprave penale bashkëkohore. Tregimi përfundon me paraqitjen e dënimit me burg kah fundi I shekullit XVIII dhe fillimi i atij XX dhe sot dëshpërimi nga ky lloj dënimi le hapësirë që dënimi me gjobë, personi të kthehet në skenën penalo-juridike.⁵

Dënimi me gjobë si një formë e sanksionit penal është forma kryesore juridike e shtrëngimit të aparatit shtetëror, i formuar me qëllimin kryesor ndëshkimin dhe parandalimin e veprave penale dhe kriminalitetit në përgjithësi. Dënimet janë mjete juridike penale me ndihmën e të cilave arrihet funksioni mbrojtës i së drejtës penale dhe paraqesin bazën dhe qëllimin themelor të vetë ekzistimit të së drejtës penale.

⁵ Vllado Kambovski, Ismail Zendeli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq.512

2. TRAJTIMI JURIDIK I DËNIMIT ME GJOBË NË KUADËR TË LEGJISLACIONIT TË RMV-SË

Sistemi i sanksioneve është pasqyrë e politikës kriminale të shtetit si paraqitje e përgjithshme orientuese, ekonomike, politike dhe social-kulturor.

Sistemi i sanksioneve penalo-juridike është pjesë e sistemit të së drejtës penale që e përfshin edhe nxjerrjen dhe zbatimin e ligjeve penale, e kjo përsëri si pjesë e politikës kriminale të shtetit. Karakteristikë kryesore e sistemit dhe politikës kriminale gjithmonë kah preventivi i përgjithshëm dhe kah orientimi i idesë preventive në sistemin e sanksioneve penalo-juridike.

Sistemi i sanksioneve si formë juridiko-institucionale i mjeteve dhe metodave të politikës kriminale duhet gjithmonë të mbetet në rrafshin e nevojave për shkatërrim efikas të kriminalitetit duke parë në rrafshin e paraqitjes së formave të veprave të rënda kriminale si: terrorizmi, krimi i organizuar, korrupsioni, vepra këto që kërkojnë angazhim më të madh të institucioneve të shtetit. Që nënkupton që sistemi i sanksioneve penale duhet të jetë i përshtatshëm me format konkrete të kriminalitetit, në të kundërtën dukshëm do të ndihmojë në përhapjen e tij.

Karakteristikë themelore e sistemit bashkëkohor është edhe dinamika e saj: mjetet institucionale juridike në luftë kundër krimit që i përmbajnë, duhet gjithmonë bashkë të përshtaten me nevojën për efikasitet në shkatërrimin e tij me mjete civilizuese dhe mundësi konkrete të shtetit për zhvillimin e masave dhe të institucioneve të afta që ti zbatojnë në përputhje me qëllimet e tyre ligjore.⁶

Karakteristikë tjetër kryesore e sanksioneve penale janë këto;

1. Sanksionet penale definoohen si mjeti me të cilin shoqëria mbrohet nga kriminaliteti;
2. Mjete këto që u shqiptohen kryerësve të veprës penale;
3. Çdo sanksion që u shqiptohet kryerësve të veprave penale duhet të jetë I paraparë si sanksion penal me ligj(*nulla poena sine lege*);
4. I shqipton gjykata me procedurë të përcaktuar me ligj me çka kryerësve u kufizohen disa liri dhe të drejta.

Se si trajtohet dënimi më gjobë në kuadër të ligjit aktual për dënime në shtetin tonë, duhet ndalë e studiuar më në detaje ligjin aktual, dënimet, lartësia, dhe shumë të dhëna tjera që pikërisht dalin nga ky objekt studimit. Gjoha u pa, në përgjithësi, si një

⁶ Vllado Kambovski, Ismail Zendeli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq.451-453

mundësi efektive dënimi, ku një person dënohet për një vepër të lehtë, për të cilën gjykata nuk konsideron ndonjë mundësi tjetër dënimi, që të jetë e përshtatshme dhe më e efektshme. Në të tilla raste, aplikimi i dënimit me gjobë i plotësojë të gjitha qëllimet e dënimit ndaj autorit, për rehabilitimin e tij në një periudhë relativisht të shkurtër kohore.

Teoria e së drejtës penale si avantazhe të dënimit me gjobë konsideron karakterin më human në krahasim me dënimin me burgim, duke e parë si një mjet adekuat për të mos u zbatuar dënimi me burgim afatshkurtër. I dënuari me gjobë duke mos mbajtur vulën e të burgosurit, nuk stigmatizohet pa nevojë dhe është më lehtë të përmbushën postulatet e individualizimit të dënimit. Gjithashtu, për ekzekutimin e tij shteti nuk ka nevojë të shpenzojë mjete materiale siç është rasti me dënimin me burgim. I dënuari nuk i ekspozohet ndikimit të delinkuentëve të rrezikshëm, si dhe ai nuk veçohet nga familja, dhe nuk humbet vendin e punës.⁷

E dimë se dënimi me gjobë është veçanërisht i qartë dhe i saktë për rastet e veprave penale realisht të lehta, mirëpo në mënyrë restriktive mund të zbatohet edhe në lëmin e kriminalitetit të quajtur të mesëm.⁸ Në ndërlidhje me rëndësinë e dënimit me gjobë, në perceptimin e mentalitetit të konsumues, Makijaveli në mënyrë spirituoze e shprehte këtë mendim: "Njeriu më shpejtë e harron vdekjen e të atit, se humbjen e parasë".⁹ Në sistemin e dënimeve që dalin na kodet penale, mund të themi se dënimi me gjobë është më i butë në krahasim me dënimin me burg dhe aplikohet për veprat penale të lehta. Teoritë e shumta juridike dhe legjislacioni penalo-juridik, pas alternativave të dënimit, është i orientuar drejt qasjes së dënimeve afatshkurtra me burgim dhe zëvendësimit të tyre me dënimin me gjobë. Efekti dhe funksioni i dënimit me gjobë nuk duhet të jetë që të dënuarit t'i merret fitimi pasuror i realizuar me veprën penale. Kjo sepse gjoba është dënim dhe matja e tij duhet të bëhet sipas dispozitave të cilat vlejné për matjen e dënimit.

Nëse ndalemi dhe analizojmë pikërisht Kodin Penal të RMV-së janë paraparë në mënyrë shprehimore qëllimet e dënimit, dhe ato janë:

1. Ta parandaloj kryerësin nga kryerja e serishme e veprës penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij dhe
2. Të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga ajo që thamë më lartë dhe duke i pasur parasysh elementet konstitutive si dhe

⁷ Vllado Kambovski, Ismail Zendeli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq. 885

⁸ Ismet Salihu dhe/ Mr.Sc. Hilmi Zhitija /Fejzullah Hasani —Komentari I Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, 2014, fq 199

⁹ Po aty, fq.199

funksionin që duhet ta ketë dënimi, e drejta penale bashkëkohore i cakton një serë karakteristikash, apo cilësi, tipare që duhet realizohen me rastin e shqiptimit të dënimit dhe ekzekutimit të tij. Këto karakteristika themelore të dënimit janë¹⁰.

E para dënimi duhet të jetë i natyrës personale. Pra pasojat e dënimit duhet ta godasin vetëm kryerësin e veprës penale. Anë pse, në mënyrë absolute nuk mund të jetësohet kjo cilësi e dënimit, ngase dënimi në mënyrë indirekte i godet edhe të tjerët.

E dyta dënimi duhet të jetë human, pra të dënuarit mos ti shkaktohen mundime fizike, e as psikike. Të dënuarit duhet t'i hiqen ose kufizohen lirit dhe të drejtat e caktuara vetëm sipas masës dhe mënyrës së përcaktuar me ligj..

E treta- dënimi duhet të jetë i moralshëm. Dënimi duhet të zgjojë ndërgjegjen e të dënuarit për shkeljen, cenimin dhe dëmtimin e vlerave të caktuara morale dhe juridike, dhe të bindet për veprimet e veta të ndaluara.

E katërta- dënimi duhet të jetë i ligjshëm – i përcaktuar me ligj. Parimi i ligjshmërisë-*nulla poena sine lege*, duhet t'i përmbushi dy kërkesa.

E pesta-Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës, me saktë, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe shkallën përgjegjësisë të kryerësit të veprës penale. Proporcionaliteti dhe drejtësia e shqiptimit të dënimit në të drejtën penal duhet të nënkuptojë faktin se, me rastin e caktimit të dënimit kryerësit të veprës penale, duhet të merren parasysh, jo vetëm pesha e veprës penale, rrezikshmëria shoqërore veprës dhe shkalla e përgjegjësisë penale – fajësia e kryerësit të veprës penale, por edhe rrethanat tjera lehtësuese dhe rënduese.

E gjashta- Dënimi duhet të jetë i barabartë- i njëjtë për të gjithë kryerësit e veprave penale dhe në kufijtë e individualizimit të dënimit, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, bindjen politike, fetare a filozofike, gjendjen ekonomike arsimore, sociale ose përkatësinë prindërore, përkatësinë racore, etnike, kombëtare, apo përkatësinë gjuhësore të kryerësit të veprës penale.

E shtata- Dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm. Kjo cilësi e dënimit në të drejtën penale nënkupton faktin se, dënimi duhet të jetë i tillë që të mënjanojë pasojat të cilat lajmërohen si rezultat i vet natyrës së dënimit- si rezultat i shqiptimit dhe ekzekutimit të tij.

E teta- Dënimi duhet të jetë i revokueshëm. Kjo cilësi e dënimit ka për efekt përmirësimin e gabimeve të mundshme gjyqësore.

E nënta- Dënimi duhet të jetë zëvendësueshëm. Kjo cilësi e dënimit vë në pah faktet se,

¹⁰ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e përgjithsme, Tetovë, 2018, f. 261

në të gjitha rastet e arsyeshme, kur është e mundshme, dënimi mund të zëvendësohet me dënim tjetër, me kusht që dënimi tjetër të jetësoj më me sukses qëllimin e dënimit.

E dhjeta – Dënimi duhet të jetë i ndarë, më saktë, duhet t'i përshtatet veprës penale dhe vet kryerësit të veprës penale. Dënimi është i ndarë atëherë kur mund të shqiptohet në kohëzgjatje të shkurtër ose në kohëzgjatje me të gjatë, varësisht nga pesha e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe rrezikshmërisë se kryerësit të veprës.¹¹

Sipas KPM-së për veprën penale kryerësit të veprës penale mund ti shqiptohen këto pesë lloje dënimesh: burgim, dënim me gjobë, ndalimi ushtrimit të profesionit, ndalim i drejtimit të automjetit dhe dëbimi I të huajt nga vendi.¹²

Nëse për një vepër penale janë paraparë dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë, atëherë si dënim kryesor mund të shqiptohet vetëm njëri prej tyre nëse me ligj nuk është i paraparë se mund të shqiptohen të dy dënimet.¹³

Në kuadër të legjislacionit të RM-së dënimi me gjobë ka hapësirë të konsiderueshme në zbatimin e tij ndaj kryerësve dhe veprave penale konkrete.

Në kodin penal aktual të RM-së në mënyrë decide është i paraparë dënimi me gjobë në çdo kapitull të klasifikimit të veprave penale. Në vazhdim do të përshkruaj një pasqyrë të dënimit me gjobë në çdo kapitull të kodit penal të RM-së.

Në kapitullin lidhur me veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut dënimi me gjobë është i paraparë në veprën penale lëndimi trupor ku dënimi me gjobë shqiptohet me dënimin me burgim deri në tre vjet. Po ashtu edhe për veprat; mosdhënia e ndihmës dhe kërcënimimi me mjet të rrezikshëm gjatë rrahjes apo përleshjes, vepra këto me të cilat është i paraparë dënimi me gjobë së bashku me dënimin me burg.

Në kapitullin XV veprat kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut, dënimi me gjobë është i paraparë ndaj personave juridik për veprën penale shkelja e barazisë së qytetarëve, shkelja e së drejtës së përdorimit të gjuhës dhe alfabetit si dënim I vetëm. Por edhe për shumë vepra tjera penale si: shkelja e paprekshmërisë së banesës, bastisja e kundërligjshme, publikimi i paautorizuar i shënimeve personale, keqpërdorimi I të dhënave personale, pengimi i tubimit publik, shkelja e së drejtës së grevës, dënim me gjobë shqiptohet së bashku me dënimin me burgim.

Gjoha si dënim së bashku me dënimin me burg shqiptohet edhe ndaj veprave penale kundër marrëdhënies së punës: cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës,

¹¹ Bajram Ukaj, Dënimet në të drejtën penalë të Shqipërisë, Prishtinë, 2006. fq 213-215

¹² Vllado Kambovski, Ismail Zendeli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq..504

¹³ Afrim Osmani: Kodi penal i RM, neni 33 pika 3 dhe 4, Shkup, 2010, fq.56

keqpërdorimi i të drejtës së sigurimit social.

Në kapitullin e veprave penale kundër nderit dhe autoritetit: veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit të njeriut, veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër drejtësisë, veprat penale kundër rendit publik.

Në kapitujt e lartpërmendur dënimi me gjobë në të shumtën e rasteve shqiptohet me dënimin me burgim, por edhe si dënim i vetëm kur me ligj është i paraparë si sanksion i vetëm për veprat penale të rrezikshmërisë së vogël. Veçmas veçohet në kapitujt e fundit me veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtarlleku aplikueshmëria e dënimit me gjobë është e paktë për nga rrezikshmëria shoqërore dhe kryerësit e veprave të tilla penale si recidivist(përsëritës) të veprave të kryera penale.

3. NDRYSHIMET DHE SFIDAT E DËNIMIT ME GJOBË GJATË SHEKULLIT XXI

Ligjet ndryshojnë, përmirësohen shtohet, thënë me mirë evulojnë. Dënimi me gjobë është një nga dënimet më të rëndësishme të gjitha legjislacioneve penale të vendeve të zhvilluara. Ai ka ndryshuar dhe është përshtat formave të bashkëjetësësë moderne dhe bashkëkohore. Në fillim të viteve '90 në vendet e Europës perëndimore dënimet me gjobë zinin nga 35-85 % të të gjitha dënimeve të dhëna nga gjykatat¹⁴. Shkalla e aplikimit të dënimit me gjobë ndikohet më pak nga fakti nëse një vend ka adaptuar sistemin e gjobave ditore (day fines) apo gjobat e përcaktuara (fixed summary fines) sesa nga fakti se sa shumë alternativa të tjera të dënimit me burgim zbaton ai sistem dhe cila është shkalla e aplikimit të këtyre alternativave.

Shikuar historikisht deri të arritja e kësaj shkalle të efikasitetit të dënimit me gjobë në legjislacionet penale, vet e drejta penale ka hasur me sfida të shumta; filluar nga delege lata(sic është) frazë latine që do të thotë sipas ligjit ekzistues. Kjo vlen edhe për t'iu referuar ligjit të vendosur sic gjendet në moment. Po ashtu edhe përpjekjet e shumta shekujt e fundit delege ferenda(sic duhet të jetë) term latin për reformat e ardhshmet ligjit

¹⁴ Frase, S. R. (2001). Comparative Perspectives on Sentencing Policy and Research. In: M. Tonry and R.S. Frase, eds. Sentencing and Sanctions in Eastern Countries. Neë York: Oxford University Press, f/ 162

apo propozim ligjit konkret. Ky konsiderohet një rekomandim që duhet të merren parasysh si të përshtatshme në një ndryshim të ardhshëm legjislativ.

Sfidë tjetër ka qenë globalizimi ku shtetet gjithnjë e më shumë shprehin interesim për bashkëpunim politik dhe juridik, harmonizimin e veprave penale, në luftë kundër terrorizmit një dukuri shqetësuese kohën e fundit.

Është e drejta bashkëkohore penale në të shumtën e rasteve për numër të caktuar të veprave penale kur nuk është i domosdoshëm dënimi me burg, theksuar edhe anët e tij negative aplikohet dënimi me gjobë, kompensim material i dëmit.

Dënimi me gjobë ka përparësitë e tij pasi që është i ndarë dhe lehtë mund ti përmbush postulatet e individualizimit të dënimit dhe se për ekzekutimin e tij shteti nuk ka nevojë të ndaj mjete materiale siç është rasti me dënimin me burg.¹⁵

Dënimi i sotëm me gjobë i theksuar me të gjitha ndryshimet dhe sfidat e tij vjen në shprehje zbatimi i tij si dënim kryesor për vepra penale të kriminalitetit të mesëm dhe si dënim sekondar bashkë me dënimin me burg në kodin penale të RM-së.

Kur jemi të të dhënat e parë të dënimeve mund të theksojmë se sistemi i dënimit të gjobave ditore është implementuar për herë të parë në vitin 1921 në Finlandë dhe më pas është shtrirë në shumicën e vendeve evropiane duke përfshirë Danimarkën, Suedinë, Gjermaninë, Austrinë, Francën Hungarinë, Poloninë, Portugalinë, Spanjën, Zvicrën.¹⁶ etj. Megjithëse sistemi i gjobave ditore aktualisht është implementuar nga shumica e vendeve evropiane, gjithsesi vendi me suksesin më të madh në aplikimin e tyre është Gjermania, e cila që nga reforma e parë ligjore penale e vitit 1969, ka patur më shumë se 80 % të të dënuarve me gjobë (Heinz, 2006). Në vitin 2004, nga 670.279 të dënuar të rritur, 540.209 (ose 80.6 %) janë dënuar vetëm me gjobë.

Shteti demokrat i Europës, Gjermania implementoi dy reforma të mëdha penale në vitin 1969 dhe 1975. Reforma e parë penale e miratuar në vitin 1969, rivendosi gjobën si sanksion penal dhe e bëri atë dënimin kryesor për krime që dënohen deri në 6 muaj burgim apo më pak.¹⁷ Ky rregullim ligjor u bë pasi shumë studime të kohës kanë treguar se dënimet me burgim të shkurtër bëjnë fare pak për të përmirësuar të pandehurit dhe se të pandehurit me rrezikshmëri të pakët të cilët dërgohen në burg për një kohë të shkurtër, bëhen më të rrezikshëm nga vetë sistemi dhe dalin prej tij më të dhunshëm sesa ç'ishin kur

¹⁵ Ismet Salihu: E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2005, fq.456

¹⁶ Grebing, G. (1982). The Fine in Comparative Law: A Survey of 21 Countries (Institute of Criminology, Occasional Paper, f. 32

¹⁷ Friedman, 1983, f. 281.

u burgosën. Pastaj kemi dhe reformën e dytë ligjorë të miratuar në vitin 1975 ndryshoi në mënyrë drastike llojin e gjobës duke kaluar në sistemin Skandinav të “gjobës ditore” e cila varion në bazë të të ardhurave të të pandehurit. Sistemi gjerman bazohet në “të ardhurat neto ditore” ose në atë që i kushton një njeriu të lirë¹⁸.

Kodi penal i Finlandës në kapitullin e dytë, seksioni i dënimeve, parashikon gjobat ditore si një sanksion penal (i ndryshuar së fundmi me ligjin 550/1999). Numri minimal i njësive të gjobave ditore është një dhe maksimumi është 120. Shuma e një gjobë ditore llogaritet si 1/60 e të ardhurave mujore neto e të dënuarit. Gjykata verifikon të dhënat e tatimeve për të dënuarin për të përcaktuar të ardhurat e tij. Nëse gjoba nuk paguhet, dy gjoba ditore konvertohen në një ditë burgim.

Shteti skandinav, Suedia adaptoi gjobat ditore në 1931¹⁹. Suedia aplikon “ekonominë strikte” si formë të gjobave ditore. Numri i njësive të gjobave ditore rritet me rrezikshmërinë e veprës, por nuk përshkallëzohet nëse autori ka kryer disa herë të njëjtën veprë. Megjithëse e ngjashme me vendet e tjera, Suedia ka një specifikë pasi mbi 75% e gjobave në Suedi vendosen nga prokurorët me marrëveshje të të akuzuarit ²⁰Në këtë vend dënohen me gjobë çdo vit mesatarisht rreth 70,000 nga 110,000 të dënuar. Gjykatat, prokuroria dhe policia kanë akses të palimituar në të dhënat e njohura nga autoritetet e taksave, megjithëse një informacion i tillë në praktikë rrallë herë përdoret ²¹Ekzekutimi i gjobave bëhet në mënyrë rutinore nga policia si një proces mbledhje borxhesh dhe refuzimi për ti paguar çon në konfiskim të makinës dhe mobiljeve.

Edhe shteti afër Suedisë, pra në, Danimarkë gjobat ditore u parashikuan në vitin 1939 ²²dhe variojnë nga një në 60 njësi. Ato mund të caktohen si dënim i vetëm apo të shoqëroren edhe me sanksione të tjera (si burgim, punë në shërbim publik etj.). Mosshlyerja e gjobës çon në konvertimin e saj në paraburgim sipas një raporti të caktuar. Në Danimarkë edhe policia dhe prokuroria mund të caktojnë gjoba, por ato janë gjoba fikse dhe të sheshta. Në ndryshim nga Suedia, në Danimarkë gjykatat mund të përshkallëzojnë dënimin në rastet e përsëritjes së krimit.

Është fakt i interesant se si Mbretëria e Bashkuar i ka përdorur shkurtimisht “gjobat me njësi” të bazuara në të ardhurat e disponueshme javore. Projekte pilote u

¹⁸ Junger-Tas, J. (1994). Alternatives to Prison Sentences Experiences and Developments. Amsterdam and Neë York: KuglerPublications, f. 23.

¹⁹Thornstedt, H. (1978). The Day-Fine System in Sëeden. The Criminal LaëRevieë, f. 307

²⁰ Thornstedt, H. (1978). The Day-Fine System in Sëeden. The Criminal Laë Revieë, f. 308

²¹ Albrecht, 1987, f. 8.

²² Thornstedt, H. (1978). The Day-Fine System in Sëeden. The Criminal Laë Revieë, f. 307

vendosën në katër gjykata magjistratësh dhe u vlerësuan nga Home Office Research and Planning Unit. Megjithëse gjetjet ishin pozitive dhe Criminal Justice Act i 1991 vendosi një sistem kombëtar të gjobave me njësi që të hynin në fuqi në tetor 1992, ky sistem u braktis 7 muaj më vonë.²³ Arsyet e vërteta për këtë ndryshim janë të paqarta, por shumë autorë fajësojnë mbulimin e keq të mediave dhe keqzbatimin e gjobave si një justifikim për ta braktisur²⁴.

Në vendet tona më të afërta, dënimi me gjobë në Itali (e njohur si pene pecuniarie) ndahet nga neni 17 i Kodit penal në “multa” që është një gjobë për krimet dhe “ammenda” për kundërvajtjet²⁵ Gjoha për krimet varion nga 50-50.000 euro, ndërsa për kundërvajtjet nga 20-20.000 euro (Kodi penal italian 2014). Megjithëse Italia nuk ka përqafuar sistemin e gjobave ditore, në nenin 133-*bis*. parashikohet se në përcaktimin e masës së gjobës, përveç kriterëve të përgjithshme të caktimit të dënimit gjyqtari duhet të mbajë parasysh dhe kushtet ekonomike të të dënuarit. Sipas këtij neni nëse gjyqtari vlerëson se masa e gjobës që parashikon ligji është e butë, mund ta trefishojë atë dhe nëse vlerëson se është shumë e rëndë mund ta ulë deri në 1/3 e saj.

Megjithëse siç u pa Italia ka një sistem të sheshtë të caktimit të gjobave, pesha që ka zënë ky lloj dënimi në praktikën gjyqësore ka qenë e konsiderueshme. Nga viti 1996-2004 dënimi me gjobë ka zënë rreth 50 % të gjithë totalit të dënimeve për krime dhe për kundërvajtje dhe rreth 40% të dënimeve për krime.²⁶ Megjithatë aktualisht ky lloj dënimi konsiderohet aktualisht në një impakt praktik për shkak të krizës ekonomike, problemeve të kriterëve të caktimit të këtij dënimi dhe ekzekutimit të tij²⁷ ku në vitin 2011 përqindja e dënimeve me gjobë ka rënë në 28.8%²⁸

Të dhënat befasuese vijnë dhe nga Kodi i penal Francez parashikon një sistem të gjobave ditore për krime dhe për kundërvajtje. Po ashtu ky kod parashikon në nenet 131-5 konvertimin e dënimit me burg në gjobë ditore. Po ashtu nenin 131-13 siguron një aplikim shumë të gjerë të gjobave për krime të lehta të ndara në 5 shkallë.

Në shtetin tonë, në RMV, nga të dhënat që dalin nga Kodi penal, del se ai ka pas ndryshime edhe atë në vitin 2004, ku ajo e parashikon sistemin e gjobave ditore në nenin 38, duke parashikuar si minimum 5 gjoha ditore dhe si maksimum 360 të tilla dhe ku

²³ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e përgjithsme, Tetovë, 2018, f. 264

²⁴ Tonry and Lynch, 1995, f. 130-131.

²⁵ Miedico, 2008. f. 20

²⁶ Miedico, 2008. f. 20

²⁷ Polinsky & Shavell, 1998. f. 78)

²⁸ (ISTAT. 2001, F. 117

minimumi i një gjobe ditore mund të jetë 1 euro dhe maksimumi 5.000 euro. Sipas këtij neni vlera konkrete e një gjobe ditore përcaktohet nga niveli i të ardhurave ditore neto të të pandehurit. Po ashtu vende të tjera të Ballkanit si Sllovenia dhe Kroacia kanë vite që e kanë implementuar me sukses²⁹ sistemin e gjobave ditore.

Edhe Kodi penal grek në Greqi, në nenin 82 parashikon një hapësirë të aplikimit të dënimit me gjobë për vepra penale të lehta të cilat janë dënuar deri në dy vite burgim ose për pjesë të mbetura të një dënimi më të rëndë. Konvertimi i dënimit me burg në gjobë edhe sipas këtij kodi është i përshkallëzuar sipas një sistemi përlllogaritjeje ditor nga 4.4-59 euro dhe në raste pamundësie pagese gjykata mund ta ulë përsëri masën deri në 1/3 e saj.

Pesha që i kanë rezervuar dënimit me gjobë legjislacionet përkatëse penale të vendeve europiane dhe gjykatat e këtyre vendeve duket se është në përpjesëtim të zhdrejtë me shkallën e burgosjes. Vende si Gjermania, Finlanda apo Suedia me një aplikim të gjerë të gjobës si dënim penal kanë norma të ulëta të burgosurve, ndërsa vende me një aplikim inferior të saj si Anglia, Estonia apo Shqipëria kanë një nivel të lartë të burgosurve.

Nga shqyrtimi krahasues vërehet se në shumë vende të Evropës Perëndimore dënimi me gjobë përdoret gjerësisht krahas alternativave të tjera të dënimit me burgim si zgjidhje më e drejtë dhe më e zgjuar për të luftuar kriminalitetin dhe ulur kostot ekonomike dhe njerëzore të burgimit. Shumica e këtyre vendeve kanë adaptuar sistemin e gjobave ditore, e cila ofron një barazi më substanciale të dënimeve për persona me mundësi të ndryshme ekonomike, duke rritur kështu shanset e një procesi më të suksesshëm edukues dhe rehabilitues të të dënuarve. Mund të përfundojmë studimin e kësaj pjesë me të të dhënë se Gjermania është vendi model i suksesit të aplikimit të dënimit me gjobë, ku në mënyrë konsistente dhe për një kohë të gjatë ka treguar me shifra se është mënyra më e mirë për kontrollin e kriminalitetit dhe njëkohësisht mbajtjen në nivel të ulët të normës së të burgosurve. Për fat të mirë, studimi dhe kopjimi i eksperiencave më të mira ligjore të vendeve më të zhvilluara nuk përbën plagjiaturë, madje është e inkurajuar nga vendet që i aplikojnë.

²⁹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e përgjithsme, Tetovë, 2018, f. 512

KAPITULLI II

DËNIMI ME GJOBË NË KODIN PENAL TË RMV-SË

1.PËRKUFIZIMI I DËNIMIT

Dënimet janë mjete juridike penale me ndihmën e të cilave arrihet funksioni mbrojtës i së drejtës penale dhe paraqesin bazën dhe qëllimin themelor të vetë ekzistimit të së drejtës penale. Dënimet janë masa dhune të cilat janë të parapara në kodin penal dhe të cilat i shqipton gjykata kundër kryerësve të veprave penale, me qëllim të mbrojtjes së vlerave më vitale të individit dhe të shoqërisë në përgjithësi, dhe të luftimit të dukurive negative dhe kriminalitetit në tërësi. Pra mund të themi me bindje të plotë se dënimet janë pjesa me dinamike e së drejtës penale.

Dënimi me gjobë është dënim me pasuri që përbëhet në imponimin e të dënuarit me obligim penalo-juridik për të paguar shumë të hollash shtetit për veprën e kryer penale.³⁰

Si dënim publiko-juridik ai nënkupton pagimin e shumës së të hollave shtetit dhe jo obligim civil I kryerësit kundër shtetit. Shqiptimi i dënimit me gjobë statuo obligimin për pagesë ekskluzivisht shtetit dhe jo të dëmtuarit, kërkesat e pasurisë sigurohen me kthimin e lëndëve ose me konfiskimin e shfrytëzimit të pasurisë ose dëmshpërblimin e dëmtimit.³¹

Dënimin me gjobë apo me të holla e njohin të gjitha legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore. Në mesin e dënimeve kryesore për nga pesha, dënimi me gjobë është lloj i dënimit më të lehtë. Me anë të këtij dënimi e drejta penale bashkëkohore aspiron që kryerësit të veprave penale të lehta madje edhe të mesme. Përparësi e këtij dënimi qëndron në atë se dënimi me gjobë I përmbush postulatet e individualizimit të dënimit dhe se për ekzekutimin e tij shteti nuk ka nevojë të ndajë mjete materiale siç është rasti me dënimin me burg.

Dënimi me gjobë bën pjesë në llojet e dënimeve pasurore. Me anë të këtij dënimi kryerësi i veprës penale detyrohet që brenda afatit të kaluar të paguaj shumë të hollash për

³⁰ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, f. 262

³¹ Poa ty, fq. 512

veprën e kryer.³²

Dënimi me gjobë përkufizohet si dënim pasuror, qëllimi i vet dënimit me gjobë është pagesa e një shumë të hollash, me këtë edhe kufizimin e disa veprimeve të vet kryerësit, me vet faktin e shqiptimit të këtij dënimi i cili godet personalisht kryerësin e veprës, zvogëlimin e pasurisë së tij dhe zvogëlimin e gjasave për të kryer vepër tjetër penale.

Historiku i zhvillimit të së drejtës penale dhe i dënimeve është vet historiku i civilizimit njerëzor, sepse dënimet paraqiten krahas me paraqitjen e shoqërisë. Kur thuhet kjo merret parasysh fakti, se gjatë tërë zhvillimit të shoqërisë njerëzore kanë qenë prezentë veprimet e dëmshme dhe të ndalueshme të individëve të caktuar kundër të cilëve shoqëria me dënime të caktuara ka luftuar këto veprime të dëmshme. Ndryshimet e shumta në të drejtën penale, në shumë vende të botës, pra edhe në Shqipëri janë bërë në sistemimin e dënimeve penale. Në këtë drejtim janë hapur procese me rendësi në gjithë botën, por edhe në Shqipëri, në aspektin e pluralizimit të dënimeve penale, të cilat tash por edhe në të ardhmen do të kenë ndikim në të drejtën penale, mu për këtë pjesa me dinamike në të drejtën penale janë dënimet

2.LARTËSIA E DËNIMIT

Me rastin e matjes së lartësisë së dënimit me gjobë dhe aplikimit të dënimit me gjobë, veçmas duhet të mbahet parasysh gjendja e tërësishme materiale e kryesit, në mënyrë që personat me gjendje materiale të ndryshme, peshën e këtij lloji të dënimit ta ndiejnë njësoj. Në të kundërtën, nëse ky dënim do të jetë shumë i rëndë për të varfrit, ndërsa shumë i lehtë për të pasurit, atëherë ky lloj dënimi do ta humbë kuptimin dhe qëllimin e vet. Në këso raste do të shndërrohet në dënim asocial dhe do të jetë në kundërshtim e parimin e drejtësisë dhe barazisë së qytetarëve.

Lartësia e dënimit me gjobë ndaj veprave penale të parapara në kodin penal të RM-së dhe për veprat kundërvajtës të parapara me ligjin për kundërvajtje si ndaj personave fizik po ashtu edhe ndaj personave juridik.

Dënimi me gjobë i shqiptuar si dënim primar por edhe sekondar ndaj personave

³² Ismet Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2005, f.455

fizik është i pranuar sistemi i gjobës ditore. Dënimi me gjobë shqiptohet në gjobë ditore me çka numri I gjobave ditore nuk mund të jetë më I vogël se 5 e as më I madh se 360 gjoba ditore (neni 38 pika 1).³³

Gjatë përcaktimit të lartësisë së gjobës në këtë rast gjykata duhet të mbledh informacione lidhur me gjendjen pasurore të kryerësit, të ardhurat e pastra ditore nga banka, organet shtetërore dhe institucionet e tjera.

Kur dënimi me gjobë shqiptohet si dënim dytësor përskaj dënimit me burg, gjykata e përcakton në shumë të hollash .

Dënimi me gjobë si dënim dytësor nuk mund të jetë më i vogël se 20 euro në kundërvlerë të denarit, as më i madh se 500 euro në kundërvlerë të denarit (neni 38 pika 6).³⁴

Gjoba si sanksion penal juridik shqiptohet edhe ndaj veprave kundërvajtës ndaj personave fizik.

Gjoba përcaktohet dhe kumtohet si sanksion I vetëm(neni 14 pika 1).

Gjoba për person fizik përbëhet me pagesë në shumë të caktuar parash e cila nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë me denarë e as më shumë se 10 000 euro në kundërvlerë me denarë (neni 15 pika 1).

Gjoba për person përgjegjës në personin juridik ose personin zyrtar ose tregtarin individual nuk mund të përcaktohet me shumën më të vogël se 50 euro në kundërvlerë me denarë, as më shumë se 2000 euro në kundërvlerë me denarë (neni 15 pika 2).

Për kundërvajtjet e bëra nga interesi ose për kundërvajtjet me të cilët shkaktohet dëm I madh pronësor, mund të përcaktohet gjobë deri në vlerën e dyfishtë të sanksionit të paraparë në paragrafin 1 dhe 2.

Për kundërvajtjet për të cilat kumtohet gjoba aty për aty, me këtë ligj mund të përcaktohet shuma e caktuar e cila

- Për persona fizik nuk mund të jetë më e madhe se 200 euro në kundërvlerë me denarë dhe
- Për persona përgjegjës në personat juridik, person zyrtar ose tregtar individual nuk mund të jetë më e madhe se 600 euro në kundërvlerë me denarë(neni 15 pika 5)

Dënimi me gjobë në kodin penal aktual të RM-së I paraparë si dënim kryesor ndaj veprave

³³ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, f. 262

³⁴ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, f. 265

penale dhe veprave kundërvajtës.

Dënimi me gjobë shqiptohet në shumë që nuk mund të jetë më e vogël se 10 000 den e as me e madhe se 30 milion den(neni 96 pika 2).

Për vepra penale të cilat kryhen nga lakmia ose leverdia mund të shqiptohet dënim I dyfishtë dhe më së shumti deri të dhjetëfishi.

Kodi penal në mënyrë strikte parasheh mundësinë e zbatimit të gjobës për persona juridik por edhe atë përgjegjës.

Për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burg deri në 3 vjet, personi juridik dënohet me dënim me gjobë prej 500 mijë den apo nëse vepra është kryer nga leverdia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e dyfishtë nga dëmi I shkaktuar apo dobia e realizuar(neni 96 pika 1).

Ndërsa për veprat penale me të cilat është paraparë më së paku 3 vjet burg, personi juridik dënohet me gjobë deri 1 milion denarë.

Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim më së paku 5 vjet burgim, personi juridik dënohet me gjobë prej 1 milion denarë, por nëse vepra kryhet nga leverdia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e dhjetëfishit nga dëmi i shkaktuar ose dobia e realizuar(neni 96 pika 3).

Gjoha si sanksion penal o paraparë për veprat penale kundërvajtëse ndaj personave juridik si sanksion kryesor.

Gjoha kumtohet në shumën që nuk mund të jetë më e vogël se 200 euro në kundërvlerë me denarë, e as më e madhe se 5000 euro në kundërvlerë me denarë(neni 38 pika 2).

Gjoha më e rëndë shqiptohet për kundërvajtjet e shkaktuara nga leverdia me të cilët shkaktohet dëm i madh pronësor. Me ligj po ashtu mund të caktohet gjobë më e madhe nga gjoha e përcaktuar në paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni³⁵.

Me ligjin me të cilin përcaktohet kundërvajtja për kumtim të gjobës në vendin e ngjarjes mund të përcaktohet shumë e cila nuk mund të jetë më e madhe se 1000 euro në kundërvlerë me denarë(neni 38 pika 5).

Për këtë arsye, edhe pse vlejné parimet e përgjithshme për matjen e dënimit për të gjithë kryesit e veprave penale, në paragrafin 6 të nenit 34, në të cilin janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, në mënyrë specifike është parashikuar

³⁵ Afrim Osmani: Kodi penal i RM, neni 33 pika 3 dhe 4, Shkup, 2010, fq.56

se:“Gjykata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to”.³⁶

Sipas pavarësisë së shqiptimit të dënimeve , dënimet ndahen në; dënime kryesore dhe dënime plotësuese. Dënimet kryesore shqiptohen pavarësisht nga dënimet tjera. Ndërkaq, dënimet plotësuese shqiptohen krahas dënimeve kryesore dhe kanë për efekt forcimin e dënimit kryesor, plotësimin e tij dhe luftimin efikas të kriminalitetit.³⁷

Kodi penal i Shqipërisë e ka ruajtur formën tradicionale shqiptare të klasifikimit të dënimeve kryesore.

1. Dënime kryesore që mund të shqiptohen kundër kryerësve që kanë kryer krime.
2. Dënime kryesore që mund të shqiptohen kryerësve që kanë kryer kundërvajtje penale.

2.3DËNIMI ME GJOBË

Dënimi me gjobë benë pjesë në grupin e dënimeve kryesore, dhe mund të shqiptohet për krime dhe kundërvajtje penale, për dallim nga dënimi me burgim paraqet një dënim më të lehtë për arsye së në Kodin Penal, ky dënim është parashikuar që mund tu shqiptohet kryerësve të veprave penale që kryejnë krime të lehta dhe për krime të kriminalitetit të mesëm. Kurse për kundërvajtje, dënimi me gjobë është përcaktuar si mundësi në të gjitha kundërvajtjet penale krahas me dënimin me burgim, e shumë pak është parashikuar si mundësi e shqiptimit si dënim i vetëm.

Dënimi me gjobë ka mundësi të shqiptohet edhe kundër kryerësve të cilët krimin e kryejnë me motive të përfitimit të dobisë materiale ose për çfarë do lloj përfitimi tjetër material, edhe atëherë kur dispozitat penale parashohin vetëm dënimin me burgim, në kësi rastesh gjykata ka mundësi të shqiptoj krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë. Në këto raste kur dënimi me gjobë i shqiptohet kryerësit të krimit krahas dënimit me burgim, atëherë dënimi me gjobë na paraqitet si dënim plotësues.³⁸

³⁶ <http://ëëë.doktoratura.unitir.edu.al/ëp-content/uploads/2019/06/Doktorature-Ylli-Pjeternikaj.pdf>, shikuar 1.1.2020,fq.181

³⁷ Bajram Ukaj, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006., q. 217

³⁸ Bajram Ukaj, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006. f.q. 235/236

2.4 AFATET E PËRMBUSHJES SË DËNIMIT ME GJOBË

Gjatë shqiptimit të dënimit me gjobë nga gjykata me sjelljen e aktgjykimit të plotfuqishëm në procedurë të përcaktuar me ligj, fazë tjetër është edhe afati i përmbushjes së dënimit me gjobë si ndaj personave fizik ashtu edhe atyre juridik për vepra të kryera penale dhe kundërvajtëse, afate këto që dallojnë njëra nga tjetra.

Për personat fizik dënimi me gjobë ndaj veprave penale të përcaktuar me ligj nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se 3 muaj, por lejohet që pagesa e këtij me këste, periudhë kjo që nuk mund të jetë më e gjatë se 2 vjet.

Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar do të caktoj afat të ri ose nëse e vlerëson se i dënuari nuk dëshiron ta paguaj atëherë mund të urdhëroj realizim të saj me dhunë në procedurë të përcaktuar me ligj.

Afati për dënimin me gjobë për personat juridik nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së dënimit.

Afatet për përmbushjen e dënimit për veprat kundërvajtës si për personat fizik ashtu edhe për personat juridik afati për pagesën e gjobës nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 ditë e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit. Për personat fizik kur kryerësi nuk ka pronë të mjaftuar dhe nuk është i punësuar nëse lëngon nga ndonjë sëmundje ose rrethanë tjetër e ngjashme, të cilat e arsyetojnë mund të lejohet që gjoba të paguhet me këste. Në këtë rast do të përcaktohet edhe mënyra e pagesës dhe afati i pagesës i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 6 muaj(neni 16 pika 2).

2.5 PËRMBARIMI I DËNIMIT ME GJOBË

Në vet faktin e kryerjes së veprës penale nga ana e kryerësit, shqiptimin ndaj tij të dënimit me gjobë, caktimin e lartësisë së dënimit me gjobë, fazë tjetër afatet e përmbushjes së dënimit me gjobë, nëse edhe në afatet e caktuara kryerësit e veprave penale nuk e paguajnë gjobën e caktuar, fazë e fundit është faza e përmbarimit.

Qëllimi i procedurës përmbarimore.

1. Me ligj rregullon procedurën përmes të cilës gjykata dhe përmbauesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbauese.
2. Dispozitat që zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të marrë në procedurë administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar dënim detyrimi në të holla përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj.
3. Ligji për përmbarim rregullon edhe kryerjen e veprimtarisë së përmbauesve privat.

Përmbauesi privat emërohet në R.M nga Ministri i Drejtësisë për territorin e gjykatës themelore.

Përmbauesi privat I ka të gjitha kompetencat të parashikuara me ligjin për përmbarim privat.

Detyrat e përmbauesit privat:

1. Të nxjerrë urdhër për përmbarim dhe zbaton përmbarimin në pajtim me autorizimet e tij që ka.
2. Identifikimi I palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë përparimore.
3. Të mbledh të dhëna për gjendjen pasurore të debitorit.
4. Të pranoj dhe ruaj pasurinë e regjistruar dhe të siguruar të debitorit.
5. Të vlerësoj pronën, sekuestrimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme.

Përmbauesi privat është i pavarur dhe kryen funksionet vetëm në pajtim me ligjin.

Numri i përmbauesve për çdo territor të gjykatës themelore caktohet në 25 mijë banorë.

Përmbarimi si procedurë përmban në vete disa faza, faza e parë kryhet ekzekutimi, faza e dytë procedura e përmbaimit, ekzekutimi për realizimin e kërkesave në të holla dhe ekzekutimi për realizimin e kërkesave jo në të holla dhe e fundit procedura e sigurimit, sigurimi me themelimin e hipotekës, sigurimi me anë të caktimit të masave paraprake dhe sigurimi me anë të caktimit të masave të përkohshme.

Në procedurën përmbaimore parashihen disa parime bazë në procedurë si parimi i mbrojtjes së debitorit, parimet e veçanta, parimi i legalitetit.

Subjektet të cilët marrin pjesë në procedurë përmbaimore janë përmbauesi privat dhe gjykata, palët (kreditori dhe debitori) dhe pjesëmarrësit e tretë.

Përmbarimi si procedurë e fundit nëse ndaj kryerësit i është shqiptuar dënim me gjobë nuk e paguajnë gjobën e caktuar në afatin e caktuar kohor gjykata urdhëron

përmbarrim me urdhër nga vetë përmbarruesi privat i cili në këtë procedurë ka kompetenca të shumta duke rishikuar pasurinë e debitorit në këtë rast dhe ekzekutimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme.

2.6 KONVERTIMI I DËNIMIT ME GJOBË NË DENIM ME BURGIM DHE DËNIM ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

Zëvendësimi i mospagimit të dënimit me burgim është zgjidhje e padrejtë. Dënimi me gjobë në fakt mund t'i shqiptohet personit I cili nuk ka qenë në gjendje aspak ta paguaj, ashtu që paraqitet vetëm si i tërthortë i shqiptimit të dënimit me burgim. Sipas kësaj me zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënimin me burgim që më parë janë të dënuar siç duket të varfrit. Por pavarësisht nga mosdrejtshmëria, zgjedhja e zëvendësim-burgut është I pranueshëm në shumë legjislacione bashkëkohore (amerikano, angleze dhe franceze). Dënimi më burg zëvendësohet vetëm deri në shumë 20 eur në ditë për kohëzgjatja 6 muaj, çdo shumë tjetër nuk pranohet ky konvertim.

Zëvendësim-burgu nuk është lloj special i dënimit me burg por modalitet i realizimit të dënimit me gjobë.³⁹

Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë gjykata do të caktoj afat të ri ose nëse vlerëson se i dënuari nuk dëshiron ta paguaj, atëherë mund të urdhëroj realizim të saj me dhunë në procedurë të përcaktuar me ligj. Nëse dhënia e afatit të ri, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj ose realizimi i dhunshëm mbesin pa sukses, atëherë gjykata do të realizoj ashtu që për çdo gjobë ditore do të përcaktoj një ditë burg, ose kur dënimi me burg është shqyrtuar si dënim dytësor, atëherë do të përcaktoj një ditë burg me çka burgu nuk mund të jetë më I gjatë se gjashtë muaj. Nëse i dënuari paguan vetëm një pjesë të dënimit me gjobë, atëherë pjesa e lënë proporcionalisht do të shndërrohet në burg, e nëse i dënuari e paguan pjesën tjetër të dënimit me gjobë, atëherë ekzekutimi i dënimit do të ndërpritet.⁴⁰

Sipas KPM, masa punë në dobi të përgjithshme mund të shqiptohet për vepra penale për të cilët është i paraparë dënim në të holla ose dënim me burg deri në tre vjet në pëlqim me kryerësin, nëse vepra është kryer në rrethana lehtësuese dhe kryerësi më parë

³⁹ Vllado Kambovski, Ismail Zendeli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq.502

⁴⁰ <http://ëëë.slvesnik.com.mk/Issues/2E4F0BC4EF9FC2438C08C160CBAEA67F.pdf> *Kodi Penal i RMV-së, fq.61

nuk ka qenë i dënuar. Masa i shqiptohet në kohëzgjatje prej 40-240 orë që i dënuari është i detyruar t'i punoj pa shpërblim nga ana e organeve të shtetit, ndërmarrje publike, organizata humanitare, gjatë kohës së festive shtetërore, punë të shtunave dhe dielave dhe jo më pak se pesë orë në javë në periudhë prej 12 muajsh.

Përveç formës themelore KPM njeh punën për shfrytëzim të përgjithshëm si masë ndëshkuese për dënim me të holla ose dënim me burgim. Kur gjyqi do ta shqiptoj dënimin me të holla deri në nëntëdhjetë gjoba ditore ose 1800 euro në kundërvlerë të denarit ose dënim deri në tre muaj, mund që njëkohësisht të vendos me kërkesë të të dënuarit për ndërrim dënim me punë për shfrytëzim të përgjithshëm ku një ditë burg, ditë gjobe, ose 20 euro ndërrohen me tre orë punë me të cilët orët e mbledhura nuk e tejkalojnë 240 orë pune.

Reformat bashkëkohore penalo-juridike në gjurmim pas alternativave të burgut është i nxitur kah dënimet afatshkurta të burgimit dhe zëvendësimi i tyre me dënimin me gjobë. Për vepra të lehta në disa legjislacione është vënë rregulli i prioritetit të dënimit me gjobë: burgu mund të shqiptohet nëse me zbatimin e dënimit me gjobë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit. Dënimi me gjobë ka disa përparësi: me zbatimin e këtij dënimi largohen efektet negative të burgut, deprivimet personale, infektimet kriminale në burg, ndërprerje e punës dhe problemet e mëvonshme në riintegrimin e të dënuarit.

Mangësia qëndron se në mënyrë jo të njëjtë i rëndon kryerësit e veprave penale, dhe efektet e tij varen nga gjendja pasurore e ndryshuar.⁴¹

KAPITULLI III

3.1 DISA ASPEKTE KRIMINOLOGJIKE TË DËNIMIT MË GJOBË

3.1.1 DISA ASPEKTE KRIMINOLOGJIKE TË SHQIPTIMI T TË DËNIMIT MË GJOBË NË GJYKATËN THEMELORE TË GOSTIVARIT NË PERIUDHËN 200-2013

Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit me strukturën dhe dinamikën e tij⁴²). Shumë autorë që merren me studimin e fenomenologjisë kriminale, veçmas rëndësi të veçantë i kushtojnë studimit të ecurisë, dinamikës dhe vëllimit të manifestimit të kriminit.

⁴¹ Afrim Osmani, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013, fq.240,

⁴² Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000, f.115

Fenomenologjia si pjesë e kriminologjisë merret kryesisht me studimin e krimit për një periudhë kohore dhe një interval kohor në një vend të caktuar.

Fenomenologjia kriminalistike është pjesë periferike e kriminalitetit e cila merret me përhapjen e krimit, manifestimin e krimit në jetën reale, përfshirë ecurinë, strukturën dhe dinamikën, karakteristikat e tyre që përfshin kohën, hapësirën në aspektet kualitative dhe kuantitative të cilat dalin nga karakteri i tyre.⁴³

Në këtë drejtim veçmas shtrohet nevoja e studimit dhe analizës së vëllimit të tij në shoqëri. Me vëllim nënkuptojmë aspektin kuantitativ të përhapjes, pranisë së krimit në shoqëri të ndryshme.

Prandaj si detyrë e veçantë e fenomenologjisë kriminale është njohja me dinamikën e përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit në një vend të caktuar. Në kuadër të trajtimeve fenomenologjike vend të veçantë zë analizat dhe studimi i strukturës dhe ndryshimeve strukturale të kriminalitetit dhe sjelljeve delikuede në një shoqëri.⁴⁴)

Në vazhdim do ceket lidhur me ecurinë dhe dinamikën e vëllimit me gjobë, po ashtu në mënyrë tabelare dhe me grafikone do të paraqitet edhe numri i gjobave që i janë shqiptuar kryerësve të veprave penale dhe të kundërvajtjeve penale, të kryera si nga personat fizik po ashtu edhe nga ato juridik, përfshirë periudhën kohore prej vitit 2009-2013.

Gostivari si rrethinë si një nga katër qytetet më të mëdha në rrethinë, numrin e popullsisë e përbëjnë 75% shqiptarë, 20% maqedonas dhe përqindja tjetër e mbetur e nacionaliteteve të tjera. Sipas shumë statistikave nga vetë përqindja e popullsisë del se numri i kryerësve të veprave kryesisht të dënuar me dënimin me gjobë më shumë atakohet nga vetë shqiptarët.⁴⁵

Kur bëhet fjalë për vëllimin, dinamikën, tipet, llojet dhe format e kriminalitetit në një vend, zakonisht si tregues të këtyre statistikave shërbejnë statistikave kriminale qofshin ato kombëtare dhe ndërkombëtare

Në këtë drejtim me të drejtë në literaturën kriminologjike theksohet se vëllimi dhe format e krimeve dhe sjelljeve kriminale, kanë qenë të lidhura ngushtë me zhvillimin dhe transformimin e shoqërive dhe sistemeve të caktuara shoqëro-ekonomike, ku brenda afateve të caktuara kohore në vende të ndryshme ose në të njëjtin vend vërehen forma dhe

⁴³ Lupco Andonovski, Kriminologjia, Shkup, 2010, f.244

⁴⁴ Po aty, f 116

⁴⁵ Të dhënat janë nga Gjukata themelore e Gostivarit, përgjigjë e kërkesës së datës 15.11.2019, drejtuar organeve kompetente dhe sektorit të denimeve,

3.2 ECURIA E DENIMIT MË GJOBË

Kriminaliteti si dukuri negative në shoqëri e cila manifestohet në shumë segmente, përfshirë integritetin e vetë njeriut, lirinë dhe të drejtat.

Ecuria kryesisht e dënimit me gjobë në këtë rast për një periudhë kohore në një vend të caktuar është një parametër kryesor për numrin e veprave të kryera penale.

Ecuria e dënimit me gjobë analizohet po ashtu përfshirë çdo fazë të procedurës penale ndaj kryerësit, fazën e ngritjes së procedurës penale dhe deri te shpallja e aktgjyqimit të plotfuqishëm të tij.

Në vijim nëpërmjet tabelës do të paraqesim të dhëna për numrin e veprave të kryera penale dhe shqiptimin e dënimit me gjobë si ndaj veprave penale po ashtu edhe ndaj atyre kundërvajtësve.

Viti	Numri i veprave të ngritura penale për persona fizik	Numri i veprave të shpallura me aktgjykim të plotfuqishëm
2009	1022	1167
2010	945	1143
2011	927	1050
2012	834	972
2013	772	954

Tabela nr.1

Nga tabela e mësipërme mund të shikojmë disa të dhëna statistikore të dala i

⁴⁶ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000, f.116

pasojë e përgjigjes zyrtare nga Gjykata themelore e Gostivarit për periudhë kohore përfshirë vitin 2009-2013. Përgjigjen e kemi marrë me vonesë të madhe kohore, por megjithatë arritëm të sigurojmë të dhënat burimor dhe të saktë për studimin tonë. Këtu kemi analizuar për çdo vit numrin e veprave penale dhe ndaj veprave për të cilët shqiptohet aktgjykim i plotfuqishëm, periudhë kjo pesë vjeçare ku shihet se numri i veprave penale ndaj të cilave shqiptohet dënimi me gjobë nuk ekziston ndonjë dallim i madh por mund të shihet se çdo vit numri i gjobave po bie, rezultat ndoshta edhe rënie e natalitetit viteve të fundit si dhe shumë shkaqe tjera që do ti potencojmë në vazhdim me paraqitjen edhe të tabelave tjera përfshirë edhe shumë aspekte tjera fenomenologjie dhe etiologjike të dënimit me gjobë. Kjo në këtë rast shihet si indikator për numrin e veprave penale të kryera nga personat fizik.

Në vazhdim në mënyrë tabelare do të paraqesim edhe numrin e veprave të kryera kundërvajtësve ndaj personave fizik ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me gjobë dhe ndaj të cilëve është shpallur aktgjykim i plotfuqishëm.

Në tabelën në vijim do të paraqesim:

Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Numri i veprave të kryera kundërvajtëse ndaj personave fizik	2054	2354	2347	2443	2614

Tabela nr.2

Nga tabela e paraqitur ndaj kryerësve të veprave kundërvajtësve ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me gjobë shihet se numri I dënimeve me gjobë krahasuar nga viti 2009 deri në vitin 2013 dukshëm është rritur. Në vijim paraqesim tabelën:

Viti	Numri I veprave penale për persona juridik	Numri I veprave të shpallura me aktgjykim të plotfuqishëm

2009	36	49
2010	54	64
2011	40	48
2012	29	32
2013	66	82

Tabela nr. 3

Ndryshe nga tabelat e mëparshme këto radhazi të paraqitura ndaj personave juridik ndaj të cilëve shqiptohet dënimi me gjobë shihet se nga viti 2009 deri në vitin 2011 ekziston deri diku numër i njëjtë i veprave penale, në vitin 2012 kemi rënie të madhe të numrit, ndërsa viti 2013 i tejkalon edhe vitet tjera me numrin e veprave të kryera penale ndaj të cilëve është shqiptuar aktgjykim i plotfuqishëm. Në vijim paraqesim përmes tabelës nr.4:

Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Numri i veprave të kryera kundërvajtës e ndaj personave juridik	324	366	420	375	342

Tabela nr.4

Parametrat që jepen më sipër nga tabela nr.4 shihet qartë se dënimi me gjobë për persona juridik ndaj veprave kundërvajtësve është deri diku i njëjtë veçmas theksuar vitin 2011 ku numri është më i madh krahasuar me vitet tjera.

3.4 DINAMIKA E SHQIPTIMIT TË DËNIMIT ME GJOBË

Një ndër karakteristikat fenomenologjike të kriminalitetit në këtë rast dënimit me

gjobë është dinamika si dukuri negative ato nuk janë të pandryshueshme por çdoherë tregojnë ndryshime strukturën. Dinamika e kriminalitetit mund të shihet në shumë aspekte. Një ndër aspektet është se ato paraqiten si histori. Çdo periudhë e historisë dhe civilizimit përmban kriminalitetin e vet.⁴⁷ Ndryshimet e mëdha në shoqëri, ekonomi por edhe në aspekte tjera përfshijnë vetë dinamikën. Në vijim nga shumë grafikone të mëparshme shihet vetë dinamika e lëvizjes në strukturën e dënimit me gjobë në territorin e Gostivarit duke marrë parasysh shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë në rritjen e numrit të dënimeve me gjobë që pak a shumë shihet numër jo edhe aq I ndryshuar që dallon nga secili vit.

Shumë faktorë tjerë si ekonomik, politik, shoqëror dukshëm ndihmojnë në përhapjen e kriminalitetit në një vend dhe për disa vepra penale.

Dinamika e dënimit me gjobë sidomos në periudhën e fundit kohore përfshirë edhe pesë vitet 2009-2013 paraqitet si parametër apo indikator kryesor në një vend, në këtë rast në Gostivar, si dënim i shqiptuar kryerësve të veprave penale si masë më e lehtë krahas dënimit me burg në njërin anë dhe nga ana tjetër konsiderohet se me zvogëlimin e pasurisë të kryerësve të veprave penale dukshëm do të zvogëlohet numri i kryerjes së veprave penale me çka konsiderohet se dënimi me gjobë është një ndër dënimet më adekuate duke anashkaluar çdo pasojë tjetër që vjen nga vet dënimi.

3.5 MOSHA E TË DËNUARVE ME GJOBË


Mosha është gjithashtu karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënimet empirike-kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Mirëpo në këtë drejtim vërehen disa ligjshmëri dhe kategori të moshave të cilët marrin më tepër pjesë në kryerjen e veprave penale. Mosha e kryerësve të veprave penale ndahet në dy grupe: në moshë të personave të mitur dhe personave të rritur. Personat e mitur ndahen në dy grupe: të mitur të rinj 14-16 vjet dhe të mitur të rritur 16-18. Nga numri i madh i praktikave gjyqësore dalin statistika se grupet e tilla të moshave të kryerësve të veprave penale në shumë vende të botës por në këtë rast nga statistika dhe praktika gjyqësore në Maqedoni nuk vërehet ndonjë dallim i madh.

Në këtë drejtim theksohet se në brezat e nxehtë vërehet një pjesëmarrje më e madhe e

⁴⁷ Lupco Andonovski, Kriminologjia, Shkup, 2010, f.225

grupmoshave më të reja ngase si thuhet atje, për arsye klimatike dhe biologjike arrihet më tepër pjekuria biofizike dhe biopsiqike e popullatës së re ndërsa në shtetet skandinave me klimë më të ftohtë pjekuria arrihet më vonë.

Ndryshe nga kjo kategoria tjetër ndaj të cilëve shqiptohet dënim me aktgjykim të plotfuqishëm janë personat mbi 18 vjet të ndara në disa grupmosha: 18-25 si moshë e veçantë, 25-30, 30-40, 40-50, 50-60 dhe mbi 60 vjet. Në vijim kemi tabelën:



Grafikoni nr. 1. Dënimi me gjobë ndaj veprave penale

Nga tabela lart, me anë të trafikimit më ngjyra është paraqitur në mënyrë sistematike dënimi me gjobë ndaj veprave penale përfshirë gjashtë kategori grup moshash duke filluar nga mosha 18 vjeçare e deri në moshën mbi 60 vjet ku shihet qartë me përqindje të theksuar se grupmosha më shumë që atakohen me dënim me gjobë janë grupmosha 25-50 vjet. Konsiderohet se grupmosha e tillë është grupmoshë më aktive në jetën e përditshme në çdo shoqëri në njërin anë dhe në anën tjetër kjo lloj grupmoshe ballafaqohet me probleme të ndryshme në jetën e përditshme, shkak kjo që këto atakohen më shpesh me vepra të kryera penale.


Veçmas do theksoja grupmoshën 18-25 përfshirë me përqindje nga viti 2009-2013 ku dukshëm shihet edhe numri i rritur i veprave penale ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me gjobë. Kjo shkak I arsyeve të shumta me të cilën ballafaqohet kjo grupmoshë.

Grupmosha mbi 60 vjet nuk shihen parametra të lëvizjes së përqindjes prej vitit 2009-2013, kjo për shkak të moshës së tyre, aftësive të tyre të zvogëluara dhe jo çdo ditë pjesë aktive në shoqëri.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqitet numri i dënimeve me gjobë ndaj veprave kundërvajtësve për personat fizik paraqitur me përqindje për çdo grupmoshë, pjesëmarrjen e tyre në kryerjen e veprave kundërvajtësve dhe shqiptimin e dënimeve me gjobë ndaj tyre. Në vijim kemi tabelën nr.4 e cila paraqet:

		Viti				
Dënimi me gjobë ndaj veprave kundërvajtëse	Mosha	2009	2010	2011	2012	2013
		9				
	18-25	21%	18%	23%	28%	25%
	25-30	23%	24%	26%	26%	30%
	30-40	17%	28%	24%	17%	14%
	40-50	16%	13%	10%	12%	12%
	50-60	12%	12%	10%	11%	10%
	Mbi 60	11%	5%	7%	6%	9%

Tabela nr.5



Grafikoni 2. Dënimi me gjobë ndaj veprave kundërvajtëse

Nga tabela lart në mënyrë sistematike nuk do të potencoj ndonjë ndryshim drastik shikuar parametrat dhe krahasuar veprat kundërvajtëse ndaj veprave penale, mosha e kryerësve që më së shumti atakohen me dënim me gjobë, për këto vepra janë dy lloje: 18-25 dhe 25-30 që qëndron mesatarisht njëjtë por duhet theksuar se te grupmosha 25-30 kemi rritje të përqindjes së veprave kundërvajtëse në krahasim me vepra penale.

Nga numri i madh i praktikave gjyqësore dalin statistika se grupet e tilla të moshave të kryerësve të veprave penale dhe në shumë vende të botës, por në këtë rast nga statistika dhe praktika gjyqësore në Maqedoni nuk vërehet ndonjë dallim I madh duke u bazuar në parametrat e përqindjes theksuar më lart.

3.6 GJINIA E TË DËNUARVE

Gjinia dhe përkatësia seksuale në pjesëmarrjen e kriminalitetit gjithashtu vështrohet në literaturën kriminologjike dhe interpretohet në këndvështrime të ndryshme. Ekziston përshtypje në bazë të të dhënave statistikore dhe praktikës gjyqësore se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore.

Mirëpo, tani në shoqërinë bashkëkohore gjendja ka ndryshuar dukshëm ngase edhe femrat gjithnjë e më tepër po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të llojllojshme kriminale. Vërehet përqindja e kryerjes së veprave penale nga ana e gjinisë femërore prej 8-10% ku femrat marrin pjesë kryesisht në kryerjen e krimeve kundër nderit dhe dinjitetit njerëzor, kundër jetës dhe trupit dhe veçmas janë të shprehura në kriminalitetet që kanë të bëjnë me prostitucionin.⁴⁸

Përqindje e vogël e pjesëmarrjes së femrës në kryerjen e një vepre penale bazohet në atë se femra është më e ndjeshme, fakte tjera përfshinë emocionalitetin e theksuar, ciklin menstrual, shtatzëninë, lindjet, këto si shkaqe kryesore në të shumtën e rasteve duke e sjellë atë në agresivitet dhe deri te kryerja e një vepre penale. Shkaqe tjera mund të përkufizohen edhe si gjendje emocionale të cilët e çojnë atë në krimet e të porsalindurit, pjesëmarrje në prostitucion dhe shumë vepra tjera.

Atë që e karakterizon pjesëmarrjen e femrës në periudhat e mëhershme është mospërfshirja e vet femrës në aktivitete të ndryshme shoqërore, ku detyrë e saj kryesore ka

⁴⁸ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000, F. 131

qenë rritja dhe kujdesi ndaj fëmijëve.


Me vet emancipimin e femrës, kyçjen e saj në shumë sfera të jetës me çka edhe ballafaqimi I saj me situata të ndryshme jetësore, në të shumtën e rasteve shkaqe këto që ajo atakohet me shumë veprime kriminale.

Shumë studime kohën e fundit i përkushtohen studimin të gjinisë femërore në aktivitetet kriminale ku shihet numri i rritur i përqindjes në kryerjen e veprave penale.

Më poshtë do të paraqesim një tabelar për gjininë femërore dhe atë mashkullore për periudhën kohore 2009-2013 ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me gjobë ndaj veprave penale dhe atyre kundërvajtës. Në vijim kemi tabelën nr 7 :

Viti	Veprat penale		Veprat kundërvajtëse	
	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
2009	88%	12%	78%	22%
2010	86%	14%	81%	19%
2011	87%	13%	83%	17%
2012	83%	17%	80%	20%
2013	82%	18%	81%	19%

Tabela nr.7



Trafikoni nr 3. Dënimi me gjobë ndaj veprave penale dhe atyre kundërvajtës

Në tabelën e lartpërmendur të paraqitur me grafikone dhe në përqindje shihet qartë pjesëmarrja e madhe e shqiptimit të dënimit me gjobë për veprat penale dhe kundërvajtës ndaj gjinisë mashkullore. Por do veçoja pjesëmarrjen e gjinisë femërore në veprat kundërvajtës dhe pjesëmarrja e tyre po ashtu edhe në veprat penale prej vitit 2009-2013 ku vërehet një përqindje më e lartë, shkaqe këto që i potencuam më lart.

3.7 NACIONALITET I TË DËNUARVE ME GJOBË

Nacionaliteti si fenomen që studiohet në të shumtën e rasteve ka rëndësi të madhe për përfshirjen e numrit të caktuar të popullsisë në kryerjen e një vepre penale.

Për studimin e nacionalitetit në qytetin e Gostivarit për periudhën kohore 2009-2013 lë hapësirë për pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në kryerjen e veprave penale.

Gostivarin si qytet e përbëjnë shumë nacionalitete të theksuar me përqindje në: shqiptarë 66.7%, maqedonas 19.6%, turq 9.8%, rom 3.8%, vllleh 0.01%, serb 0.19%, boshnjak 0.04% dhe përqindja tjetër u takon nacionaliteteve tjera pakicë në Gostivar.⁴⁹

Gjatë analizës së përqindjes të nacionaliteteve në Gostivar gjatë të cilëve është shqiptuar dënimi me gjobë nuk do të theksoja një rritje drastike krahasuar një nacionalitet

⁴⁹ Përgjigje e kërkesës drejtuar Gjykatës Themelore të Gostivarit, sektorit të denimeve, kërkesa e datës 15.11.2019.

nga nacionaliteti tjetër duke shikuar këta në përqindjen e popullsisë që e përbëjnë ata.

Në mënyrë tabelare paraqitet përqindja e kryerësve të dënuar me gjobë si ndaj veprave penale ashtu edhe ndaj atyre kundërvajtëse duke i paraqitur në dy ndarje edhe atë përqindje e nacionalitetit shqiptar dhe nacionaliteteve tjera. Në vijim:

Vi ti	Veprat penale		Veprat kundërvajtëse	
	Shqiptarë	Të tjerë	Shqiptarë	Të tjerë
2009	70%	30%	75%	25%
2010	68%	32%	80%	20%
2011	73%	27%	82%	18%
2012	66%	34%	78%	22%
2013	74%	26%	73%	27%

Tabela nr.8

3.8 VENDI DHE KOHA E KRYERJES SË VEPRËS PENALE

Në studimet e shumta fenomenologjike të kriminologjisë, rëndësi të madhe i kushtohet edhe vendit dhe kohës së kryerjes së veprës penale.

Gjykata themelore e Gostivarit ka kompetenca të gjëra, përfshirë komunën e Gostivarit, komunën e Vrapcishtit dhe komunën e Mavrovës dhe Rrostushës.

Referimi i një studimi të vendit dhe kohës së kryerjes së veprës penale dhe ato kundërvajtëse, i referohet një analize të thellë në këtë rast se cilat nga këto vendbanime më shumë janë të prekura nga veprat e kryera dhe periudhën kohore në të cilën janë kryer këto vepra. Kryesisht kemi të bëjmë me tre komuna të cilët në vete rrethohen nga një numër i madh i fshatrave, potencuar këtu edhe Çëgranin si një ndër fshatrat më të mëdhenj.

Kriminaliteti si dukuri krahasuar qytetin prej fshatit tregojnë dallim shumë të madh


në dinamikën dhe strukturën, po ashtu edhe një etiologji të ndryshme.⁵⁰

Një ndër dallimet kryesore është se në qytet është më shumë e koncentruar industria, tregtia, ndërsa në fshatra është bujqësia. Kjo arsye më tepër të theksohet prania e më shumë njerëzve në qytet, lëvizje e madhe e popullsisë, ballafaqimi me çdo situatë qofshin ato tendencioze, shkak këto deri te kryerja e një veprë penale.

Qyteti po ashtu shërben edhe si shitje e të gjitha të mirave qofshin ato bujqësore të cilat kultivohen nëpër fshatra. Ndalea në këtë rast e fshatit krahasuar me qytetin në rrafshin ekonomik, kulturor dhe social është shumë i madh dhe do të duhet një periudhë e madhe kohore që të arrihet deri te ajo. Konstatohet fakti se kriminaliteti si dukuri më shumë manifestohet në qytet se sa në fshat, nëse krahasohet me atë të qytetit tregojnë dallime të mëdha në strukturën e brendshme dhe në formën me të cilën manifestohet.

Për fshatrat karakteristikë janë disa vepra penale kundër jetës dhe trupit, shkatërrimi i pasurisë së huaj. Ndryshe nga kjo në qytet kryhen këto vepra penale: falsifikimet, deliktet seksuale, mashtrimet, tregtia e palejuar.⁵¹

Nëpër fshatra kryesisht banojnë njerëz të moshuar të cilët nga paaftësia e tyre indikatorë ky për numër të vogël të veprave penale dhe atyre kundërvajtëse.



Grafikoni nr.1

Një ndër karakteristikat fenomenologjike është ndryshimi në periudha të ndryshme kohore. Disa autorë këtë e potencojnë edhe si ndryshime klimatike. Periudha kohore është shumë e rëndësishme për të analizuar përqindjen e kriminalitetit, në këtë rast të dënimit me gjobë për të analizuar se në cilën periudhë kohore manifestohen veprat e tilla.

Nga disa hulumtime të disa veprave penale si vepra penale të vjedhjes dhe shumë vepra tjera penale tregojnë faktin e paraqitjes në fund të vjeshtës dhe dimrit, ndërsa veprat penale kundër jetës dhe trupit, dhunimit paraqiten më shpesh në pranverë dhe në kohë të

⁵⁰ Lupco Andonovski, Kriminologjia, Shkup, 2010, f.272

⁵¹ Lupco Andonovski, Kriminologjia, Shkup, 2010, f.274

verës.

Kriminaliteti si dukuri tregon karakteristikë të veçantë gjatë javës, të lidhura ngushtë me aktivitetet e punës, shprehinë dhe zakonet. Kështu që ditët gjatë javës tregohen si kritike për disa vepra penale në veçanti ditët në fillim dhe fund të javës.

Periudha kohore lidhet ngushtë me të gjitha aktivitetet që ndërmerren në jetën e përditshme. Në statistika del se vetëvrasjet më së shumti ndodhin ditën e diel dhe të hënën, kur njerëzit nuk janë në punë ose kur jetojnë në ambiente të mbyllura i vetmuar të cilat manifestohen me depresi.

Gjatë vikendit kemi rritje të ndeshjeve automobilistike si element i disponimit por edhe si element i numrit të aksidenteve në trafik.⁵²

Kriminaliteti si dukuri negative tregohet në variante gjatë ditës. Disa nga veprat penale parimisht kryhen gjatë natës pasi që në errësirë ato janë të pavërejtur dhe të pakapshëm.

Gjatë natës kryhen disa vepra penale si: vjedhjet, përdhunimet, vjedhjet nëpër banka, gjatë periudhës së fundit kryhen edhe gjatë ditës. Aksidentet në trafik zakonisht kryhen në orët e mëngjesit kur njerëzit shkojnë në punë dhe mbas dite gjatë kthimit nga puna. Nga kërkimet dhe analizat e shumta të kryera edhe në Gjykatën Themelore të Gostivarit tregojnë se koha si një aspekt fenomenologjik meriton një vëmendje të madhe duke analizuar atë për një numër të madh të veprave penale të cilat janë si rezultat i jetës dinamike dhe ndryshimeve të shumta psikologjike dhe biofizike nga vet kryerësit. Nga të dhënat e sipër përmendura nga praktika gjyqësore, nga bisedat me jurist të punësuar në Gjykatën Themelore të Gostivarit, duke analizuar ditët e kryerjes së një vepre dhe bisedë poashtu me informacione nga Ministria e Punëve të Brendshme të Gostivarit të cilët ofrojnë të dhëna për orën e kryerjes pasi që janë ata të parët prezent në një vendngjarje.

Nga shumë analiza të kryera mund të arrihet një konkluzion se për periudhën kohore 2009-2013 nga hulumtimet e shumta konsiston një statistikë jo shumë dalluese nga ajo që u përmend më lart, veçmas theksohet për ecurinë e veprave kundërvajtëse, ndërsa për veprat penale mund të thuhet si një praktikë e veçantë dhe jo dalluese nga shumë vende tjera.

DISA ASPEKTE ETIOLOGJIKE PËR PERSONAT E DËNUAR ME GJOBË

⁵² Po aty, f. 275

Në këtë pjesë studimi do të ndalemi të disa aspekte etiologjike të të dënuarve me gjobë. Pasojë e parë ose më mirë thënë më kryesore dhe e drejtpërdrejtë e kryerjes së veprës penale është sanksioni juridiko penal, i cili është pjesë e normës juridike, që përcakton sjelljen e atij që shkel dispozitivin e saj.⁵³ Dënimet janë në epiqendër të vëmendjes të së drejtës penale dhe të politikës kriminale. Çështjet e tjera, të cilat i rregullon legjislacioni penal, sado të rëndësishme që të jenë, i referohen parakushteve për zbatimin e dënimeve dhe sanksioneve tjera apo çështjeve të tjera lidhur me zbatimin e tyre.⁵⁴ Në këtë pjesë jo pak të rëndësishme të punimit duhet të përmendim dhe pasojat e dënimit. Pasojë kryesore dhe e drejtpërdrejtë e kryerjes së veprës penale është sanksioni juridiko penal, i cili është pjesë e normës juridike, që përcakton sjelljen e atij që shkel ligjin aktual të saj.

Sanksioni në kuptimin juridiko-penal nënkupton zbatimin e masave të detyrueshme ndaj individit që kryen një vepër penale. Përveç pasojës së sipërpërmendur, pasoja të tjera të ndryshme nga e para, theksojmë pasojat ligjore nga gjykimi, që përbëhet nga të drejtat e kufizuara të caktuara, të cilat veprojnë me forcën e ligjit, gjatë gjykimit të të pandehurit, të kushtëzuara nga lloji dhe masa e dënimit. Të tilla janë, ndërprerja e marrëdhënieve të punës, ndalesa për shfrytëzimin e disa të drejtave të parashikuara në ligjet e posaçme.

Përveç fenomenologjisë si një degë kriminale duke studiuar ecurinë, moshën, nacionalitetin, vendin dhe kohën, dukë I analizuar këto në mënyrë tabelare dhe grafikone për të parë çdo aspekt të tyre që ndikon në shqiptimin e dënimit me gjobë. Për analizën e dënimit me gjobë të rëndësishëm gjithashtu janë edhe faktorët etiologjik. Etiologjia kriminale analizon dhe studion lidhjet kauzale në mes rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm dhe kriminalitetit. Etiologjia studion shkaqet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me sjelljet kriminale. Studimet etiologjike kanë për detyrë të përgjigjen në pyetjet pse ndodh kriminaliteti dhe cilët janë shkaqet e paraqitjes⁵⁵

Etiologjia kriminale kryesisht studion faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Studimi I shkaqeve të ndryshme qofshin ato të brendshme ose të jashtme, arsye e një

⁵³ Vllado Kambovski —E drejta Penale I Pjesa e Përgjithshme, Botimi i dytë, SHB —Furkan ISMI —Shkup, 2007, fq 429

⁵⁴ Shih Ismet Salihu / Mr.Sc. Hilmi Zhitija / Dr.Sc. Fejzullah Hasani —Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Botimi 1, 2014I publikuar nga Deutsche Gesellschaft Für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, fq 183

⁵⁵ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000, f. 235

kryerje të veprës penale dhe shqiptimi I dënimit me gjobë ndaj tyre duhet të analizohet nga shkalla e zhvillimit të një shoqërie dhe shumë rrethanave tjera.

Faktorët e jashtëm që ndikojnë dukshëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale janë: faktorët ekonomik-shoqëror, faktorët ideo-politik, mikrogrupor dhe socio-patologjik.

-Faktorët ekonomik-shoqëror

Si faktorë shumë të rëndësishëm etiologjik që përfshihen nga zhvillimi i hovshëm industrial, të arriturat e mëdha teknike dhe një varg transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri kanë ndikuar në formimin e njeriut dhe personalitetit të tij.⁵⁶

Si faktor ekonomik-shoqëror të cilët poashtu ndikojnë në kryerjen e një vepre penale por edhe kundërvajtëse janë industrializimi dhe urbanizimi. Me industrializim nënkuptojmë ngritjen e fabrikave, ndërmarrjeve të mëdha, zhvillimin e infrastrukturës dhe trafikut. Të gjitha këto ndryshime të shumta ku numri I madh I popullsisë kalojnë nga fshatrat drejt qyteteve, nga viset më pak të zhvilluara në metropole të ndryshme konsiderohet si një ndër shkaqet negative, si proces i hovshëm teknologjik dhe migrim i madh i popullsisë ku në qendrat e mëdha lulëzojnë lagje të pastërta, ndërsa nëpër fshatra varfëri dhe skamje.

-Migrimi- si shkak etiologjik ceket në shumë literatura kriminologjike. Shtimi i numrit të refugjatëve dhe azilkërkuesve rritet për shkak të konflikteve politike, krizave ekonomike dhe çrregullimeve sociale me çka rritet edhe cenimi i lirive dhe të drejtave të tyre.

-Kriza dhe depresionet ekonomike- me vet faktin e paraqitjes së dukurisë së krizës dhe depresioneve ekonomike vjen deri te lëshimi masovik i punëtorëve nga puna dhe ngritje e çmimeve të të mirave materiale. Kriza në të shumtën e rasteve disa individ përpiqen ta justifikojnë duke u marrë me veprime antiligjore si vjedhje, tregti e palejuar, bixhoz dhe prostitucion.

-Varfëria- si një ndër faktorët më objektiv të kriminalitetit në një vend është varfëria.

Shumë studime tregojnë se kriminaliteti në një vend është produkt I shtresave të varfëra të popullsisë, ndërsa me kriminalitet merren më pak shtresat e pasura.

Mediat raportojnë për një varfëri të skajshme si në qytet ashtu edhe në fshatra me cka mund të konsideroj se varfëria si dukuri ka kontribuar shumë në përqindje të dënimit me

⁵⁶ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000f, 255

gjobë në territorin e Gostivarit.

Nga praktika gjyqësore dhe jurisprudenca në Gjykatën Themelore të Gostivarit del në pah po ashtu kryerja e shumë veprave penale dhe kundërvajtësve nga shtesa e varfër e popullsisë.

-Papunësia- e njëjtë si dukuria e varfërisë dhe të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, papunësia e madhe e drejton popullsinë në varfëri të skajshme.

Në shumë vende të botës përveç tjerash shpjegohet edhe ndikimi i papunësisë në një vend duke raportuar me përqindje dhe parametra ndikimin e saj në jetën e përditshme në një vend të caktuar. Gati në të gjitha vendet ku është shtuar papunësia vërehet edhe rritja e formave të ndryshme të kriminalitetit, megjithatë kjo nuk do të thotë se kriminaliteti rritet nëse shtohet papunësia. Portalet e shumta paraqesin shkallën e lartë të papunësisë në Gostivar dhe rrethinë me çka i detyron qytetarët të merren me krim, ndërsa rinia me shitblerjen e mjeteve narkotike si dukuri alarmante në Gostivar.

-Kushtet e vështira të banimit- gjithashtu ndikojnë dukshëm në rritjen e përqindjes së krimeve në një vend.

Problemi i banimit ku manifestohet me lëvizje masovike të qytetarëve drejt qendrave të mëdha urbane me çka lindin mungesat e hapësirave banesore në një vend.

Qëllimi që ndjek dënimi penal me gjobë ndikon drejtpërdrejtë në larminë e dënimeve dhe masat që parashikohen nga ligji, në kriteret e individualizimit të tyre nga gjykata dhe në mënyrën dhe standardet e ekzekutimit të tyre. Në aspekt etiologjikë në këtë drejtim rëndësi të madh marrin teoritë lidhur me legjitimitetin e dënimit, si dhe studimi i qasjes filozofike ndaj dënimit penal. Në këtë kapitull janë analizuar në mënyrë të hollësishme të gjitha teoritë bashkëkohore mbi dënimin si: teoria e ndëshkimi. Teoria e parandalimit, teoria *Just Desert*, teoria e rehabilitimit teoria e paaftësisë, teoria e denoncimit, teoria Drejtësia restauruese, si dhe realizimi i qëllimit në marrëveshjen për praninë fajësie. Studimi i këtyre teorive ka shërbyer për të përcaktuar qëllimin që ndjek dënimi në legjislacionin tonë.

KAPITULLI IV

DËNIMI ME GJOBË I PËRCAKTUAR NË MËNYRË KRAHASUESE NË DISA KODE PENALE

4.1 KOSOVË

Kosova është shtet i ri dhe si tillë ka një Kod penal i cili dhe ka përjetuar disa ndryshime. Ne do të ndalemi në analizën e dënimeve me gjobë krahas dënimeve tjera. Gjatë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore lufta kundër dukurive negative është zhvilluar në mënyra dhe metoda të ndryshme të cilat dhanë një kontribut të madh në aspektin e mbrojtjes së të mirave të individit dhe shoqërisë në përgjithësi, nga sulmet dhe shkeljet e ndryshme. Dimë se këto mjete dhe metoda kanë qenë të ndryshme, dhe kjo është varë nga arritja e zhvillimit të shoqërisë së caktuar, dhe të organizimit dhe rregullimit shtetëror dhe juridik të një shteti.

Hetohet se një kohe të gjatë si mjete dhe metoda të vetme të luftës kundër dukurive negative dhe veprimeve të ndaluara, kanë mbizotëruar dënimet fizike dhe trupore, torturat fizike dhe psikike si dhe dënimet me vdekje. Por me kalimin e kohës fillojnë të zbatohen edhe dënime të tjera, si dënimet në të holla, dënimet me konfiskim të pasurisë, dhe dënimet me burgim. Ndërsa me vonë nën ndikimin e mendimeve dhe ideve të ndryshme, si metoda dhe forma për ndalimin e dukurive negative, përveç dënimeve parashihen edhe sanksione të tjera penale, si: dënime plotësuese, dënime alternative, masat edukative, dhe mjete e metoda të tjera për parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe kriminalitetit në përgjithësi.

Masa dhe dënimet më gjobë në fillim duken sikur janë masa të dhunshme të parapara me legjislacionet pozitive, dhe të cilat zbatohen kundër kryerësve të veprave penale. Dënimet paraqesin njëri nga masat me ndihmën e të cilave mbrohet individi dhe shoqëria në tërësi nga kriminaliteti, dhe janë forma të reagimit të shtetit kundër kryerësve të veprave penale. Ato rregullisht zbatohen kundër kryerësve të veprave penale, me qëllim të mbrojtjes së të mirave vitale të individit dhe të shtetit në tërësi. Dënimet si sanksione

penale i shqipton gjykata kompetente në procedurë të rregullt ligjore kundër kryerësit të veprës penale. Dënimet çdo herë që me parë janë të parapara paraprakisht me ligj, nulla poena sine lege, dhe çdo herë paraqesin shtrëngim kundër kryerësit të veprës penale i cili përherë pëson duke iu marrë disa të drejta të caktuara.

Parashikimi dhe zbatimi i të gjitha dënimeve në një shtet konform dispozitave pozitive penal quhet sistem i sanksioneve penale. Dënimet si sanksione penale janë tërësi e masave, që i ndërmerr shteti kundër kryerësve të veprave penale, të cilat veçohen me disa attribute elemente dhe karakteristika.

Dënimet si sanksione penale në sistemin bashkëkohor të ndëshkimit kanë një domethënie të dyfishtë. Kjo do të thotë se kundër kryerësve të veprave penale ka mundësi të shqiptohen dhe ekzekutohen dënimet dhe zëvendësimet e tyre si p.sh, dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore ose edhe dënimet tjera të llojit të mbrojtjes, dhe të cilat kanë karakter preventiv. Po ashtu kjo domethënie e dyfishtë shihet edhe në mundësin e zbatimit dhe seleksionimit të masave të ndryshme si masave siguruese ose masave edukative korrektuese.⁵⁷

Dënimet kryesore

Janë ato dënime të cilat ligji i parasheh se këto mund të shqiptohen si masa kryesore të ndëshkimit. Dhe këto janë lloje të dënimeve të cilat e kanë mundësin të shqiptohen si të vetme kundër kryerësve të veprave penale, dhe ketë pavarësisht prej llojeve tjera të dënimeve.

Llojet e dënimeve kryesore sipas Kodit Penal të Kosovës.⁵⁸

1. Dënimi me burgim afatgjatë,
2. Dënimi me burgim dhe
3. Dënimi me gjobë

Dënimi me gjobë

Kjo pjesë është objekti i studimit tonë. Por vetëm për analizë përmend disa llojet tjera dënimesh tjera. Dënimi me gjobë bën pjesë në grupin e dënimeve kryesore por i karakterit

⁵⁷ Halili Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2002, f. q. 65-67

⁵⁸ Kodi Penal i Kosovës, neni 36

pasuror. Me ndihmën e këtij dënimi, kryerësi i veprës penal obligohet që brenda kohës së caktuar të paguaj një shumë të hollash në dobi të shtetit. Këtë lloje të dënimit e parashohin të gjitha legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore, për nga pesha dënimi me gjobë është një lloj me i but i dënimit.

Në Kosovë, dënimi me gjobë nuk mund të jetë me pak se 50 euro, e as me i lart se 25.000 ose për vepra të kryera me qëllim të fitimit të dobisë pasurore nuk mund të jetë më i lart se 500.000 euro.⁵⁹ Kodi Penal i Kosovës ka parashikuar edhe format e ekzekutimit të dënimit me gjobë, gjykata me aktgjykim e cakton intervalin kohor brenda të cilit mund të behet pagesa e dënimit me gjobë, dhe i cili nuk ka mundësi të jetë me i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se 3 muaj, ndërsa në raste të caktuar kur gjykata e sheh të arsyeshme atëherë mund të lejoj që dënimi me gjobë të paguhet edhe me këste, por me kusht që intervali kohor i pagesës të mos zgjatë me shumë se dy vjet.⁶⁰ Nëse ndodh që personi i dënuar refuzon të paguaj gjobën ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, gjykata mund të lejoj që gjoba të paguhet në këste gjatë një periudhe e cila nuk i tejkalon dy vjet. Pas kësaj, nëse personi i dënuar vazhdon të refuzojë pagesën e gjobës ose nuk është në gjendje ta bëjë këtë, gjykata, me pajtimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësoj gjobën me një urdhër për punë në dobi të përgjithshme, e cila, sa të jetë e mundur, nuk e pengon në aktivitetet e tij të rregullta të punës.⁶¹

Nëse ndodh personi i dënuar nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, gjykata cakton një ditë burgim për çdo 15 euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos tejkalojë gjashtë muaj.⁶²

Gjysmëliria

Si lloj i dënimit alternativ, ka për qëllim që personit të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim, deri në një vit i bëhet e mundur çdo ditë, disa orë të caktuara, të mund të qëndrojë në liri për të kryer punën profesionale të cilën e ka kryer edhe gjatë kohës sa ka qen në liri, apo që të kryej punët familjare. Por me kusht që po sa të mbaroj punët

⁵⁹ Kodi Penal i Kosovës, neni 39, paragrafi 1

⁶⁰ Kodi Penal i Kosovës, neni 39, paragrafi 2

⁶¹ Kodi Penal i Kosovës, neni 39, paragrafi 3

⁶² Kodi Penal i Kosovës, neni 39, paragrafi 4

brenda orëve të lejuara në liri, i dënuar është i obliguar të kthehet në institucionin korrektues.

Për të mundur të shqiptohet gjysmëliria nga gjykata duhet të plotësohen këto kushte;

-që kryerësi i veprës penale të jetë dënuar me burgim deri në një vit;

-që për kryerësin, familjen e tij por edhe për shoqërinë, do të jetë shumë e favorshme ti lejohet vazhdimi apo përfundimi i punëve të cilat janë para tij;

-që për çdo ditë, pas kryerjes së punëve të caktuara, gjatë orëve të lejuara për të qëndruar në liri, të kthehet në institucionin korrektues.

Nëse i dënuari nuk i përmbush detyrimet që lidhen me punën, arsimin ose aftësimin profesional, nuk i kryen detyrimet themelore familjare, pranon trajtimin e nevojshëm mjekësor apo rehabilitues apo nuk kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve të tij, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg.⁶³

Dënimet plotësuese

Në Kosovë kemi dhe dënimet plotësuese janë sanksione penale të cilat janë burim i njohurive se nuk janë vetëm dënimet kryesore mjete të efektshme kundër kryerësve të veprave penale. Dhe kjo ishte arsyeja që në të drejtën penale u krijua mendimi se përveç dënimit kryesor, duhet parashikuar edhe dënime tjera të karakterit plotësues, me ndihmën e të cilave do bëhej me të lehtë luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit si dhe riedukimi dhe risocializimi i personave të dënuar. Dhe kështu e drejta penale në mesin e dënimeve ka edhe dënimet plotësuese, të cilat shqiptohen krahas dënimeve kryesore, përjashtim nga kjo bënë dënim i me gjobë i cili për nga përmbajtja e tij llogaritet si dënim kryesor dhe plotësues. Saktësisht dënimi me gjobë në rastet e parashikuara me ligj ka mundësi të shqiptohet si dënim i vetëm apo edhe krahas dënimit me burgim. Dënimet plotësuese shqiptohen me qellim që kryerësit të veprës penale ti merren apo kufizohen disa të drejta, të cilat për shkak të natyrës që kanë nuk mund të merren apo kufizohen me dënime

⁶³ Kodi Penal i Kosovës, neni 53, paragrafi 2

kryesore.⁶⁴

Kodi Penal i Kosovës i cek në mënyrë taksative dënimet plotësuese që kanë mundësi ti shqiptohen kryerësve të veprave penale. Ndërsa në dispozitat tjera, në të cilat parashikohen veç e veç dënimet plotësuese ceken në mënyrë decisive edhe kushtet që duhet të përmbushën për të pasur mundësi me u shqiptuar këto dënime.

Kodi Penal i Kosovës në nenin 54 i parasheh këto lloje të dënimeve plotësuese:

1. Gjobën
2. Heqja e të drejtës për tu zgjedhur
3. Ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik
4. Ndalimin e ushtrimit të profesionit, të aktiviteteve ose detyrës
5. Ndalimin për të drejtuar automjetin
6. Marrjen e patentë shoferit
7. Marrjen e sendit
8. Urdhrin për publikimin e aktgjykimit, dhe
9. Dëbimin e të huajit nga territori i Kosovës⁶⁵

⁶⁴ Salihu I. vep e cit., f. q. 486/487

⁶⁵ Neni 54 i Kodit Penal të Kosovës

4.2.SHQIPËRI

Shqipëria e dalë nga ideologjia komuniste, pra Shqipëria moderne, ka një Kod penal të saktë, arbitrarisht të saktë dhe me përvojë. Ka shkollë të gjyqësisë të cilën ne duhet ta marrim si model. Në Shqipëri, dënimi me gjobë parashikohet si një nga dënimet kryesore në kodin penal të Republikës së Shqipërisë, por zbatimi i tij në praktikën gjyqësore është inferior në raport me dënimin me burgim. Shumë vende të Evropës perëndimore ndër të cilat Gjermania dhe vendet nordike kanë disa dekada të cilat aplikojnë me sukses dënimin me gjobë për vepra penale me rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore. Për një drejtësi penale më të drejtë dhe të prekshme dhe për një sukses më të madh të realizimit të qëllimit të dënimit penal, shumica e këtyre vendeve kanë adaptuar sistemin e gjobave ditore.

Në botën bashkëkohore, edhe në sistemin e dënimeve në Shqipëri dënimi me gjobë paraqet njërin prej dënimeve më të shpeshta që u shqiptohet kryerësve të veprave penale, edhe atë jo vetëm si zëvendësim i dënimit me burg por edhe si dënim i pavarur dhe dënim i shqiptuar bashkë me dënimin me burgim për vepra të lehta dhe për vepra penale të rrezikshmërisë së mesme shoqërore.

Dënimi me gjobë si dënim kryesor që mund të shqiptohet për krime dhe për kundërvajtje penale në krahasim me dënimin me burg në sistemin e dënimeve në Shqipëri paraqet dënim më të lehtë sepse në kodin penal aktual të Shqipërisë ky dënim është i paraparë si mundësi e shqiptimit kryerësve të veprave penale që kryejnë krime të lehta dhe krime të kriminalitetit të mesëm. Ndërkaq, për kundërvajtje dënimi me gjobë si mundësi i shqiptimit kryerësve për veprat kundërvajtëse është i përcaktuar pothuajse në të gjitha kundërvajtjet penale krahas dënimit me burgim, e shumë pak është i përcaktuar si dënim i vetëm.

Gjatë vështrimit të dispozitave të kodit penal aktual të Shqipërisë shohim se ligjvënësi penal ka paraparë mundësinë e shqiptimit të këtij dënimi në 127 dispozita ligjore për kryerësit abstrakt të krimeve të lehta, por edhe krime me rrezikshmëri shoqërore të mesme.

Dënimi me gjobë si dënim kryesor për krime është i paraparë në nenin 29 paragrafi 1 pika 3 në kodin penal aktual të Shqipërisë.

Dënimi me gjobë për krime zakonisht nuk u shqiptohet kryerësve të cilët e kanë përsëritur krimin.

Dënimi me gjobë në kodin penal aktual të Shqipërisë është përcaktuar si dënim kryesor që mund t'u shqiptohet kryerësve edhe për kundërvajtjet penale i paraparë në nenin 29 paragrafi 2 pika 2.

Gjatë vështrimit të nenit 34 paragrafi 4 të kodit penal aktual të Shqipërisë shohim se minimumi I dënimit me gjobë për kundërvajtjet penale që mund t'u shqiptohet kryerësve për kundërvajtjet penale është pesëdhjetë mijë lekë, ndërsa maksimumi pesë milion lekë.⁶⁶ Punim ka për qëllim analizimin me një qasje kritike të çështjes së caktimit të dënimit me gjobë në vendin tonë nën dritën e eksperiencave më të mira të vendeve evropiane dhe të vetë problemeve të evidentuara në praktikën gjyqësore shqiptare. Për paraqitjen e një panorame sa më objektive të aplikimit të dënimit me gjobë në vendin tonë punimi mbështetet në metoda sasiore përmes analizimit të të dhënave dytësore të publikuara nga Ministria e Drejtësisë dhe më tej përmes vëzhgimit të një kampioni të madh vendimesh gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ky studim rezulton se megjithëse neni 34 i Kodit penal në Shqipëri është ndryshuar disa herë nga Legjislatori, përsëri ai është larg standardeve të vendeve të zhvilluara të Evropës perëndimore, pasi nuk arrin ti përgjigjet nevojës për një të drejtë penale humane, të drejtë dhe efektive në reduktimin e kriminalitetit.

Në Shqipëri dënimi me gjobë është një nga llojet e sanksioneve ekonomike⁶⁷ të cilat shteti i përdor për luftimin e fenomeneve të paligjshme. Megjithëse qëllimet që ndjek dënimi me gjobë janë përgjithësisht të njëjta me qëllimet që ndjekin sanksionet e tjera klasike, përsëri natyra e tij e diferencon në disa drejtime. Kështu dënimi me gjobë plotëson qëllimin shpagues, parandalues dhe restaurues të dënimit penal, por nuk mund të thuhet se ai plotëson qëllimin pamundësues (incapacitation) të dënimit me burgim.⁶⁸ Megjithëse paraqitja e tij në format më të para daton që në antikitet vlera dhe përhapja e tij në shoqëritë moderne ka marrë një përhapje dhe aplikim shumë më të gjerë.

⁶⁶ Bajram Ukaj, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtine 2006, 235-246

⁶⁷ Miethe and Lu, 2005, f. 53

⁶⁸ Ragim Halili, 2014, f. 93

Pavarësisht se dënimi me gjobë njihet nga të gjitha familjet e sistemeve ligjore, shkalla dhe natyra e aplikimit të tij varion nga sistemi në sistem. Kështu megjithëse dënimi me gjobë për vepra jo shumë të rënda është një praktikë e zakonshme e vendeve të zhvilluara perëndimore⁶⁹ në vendet e të drejtës islamike pagesa e një dënimi me gjobë ndaj familjarëve të viktimës mund të bëjë që gjykata të revokojë dënimin me vdekje të autorit të vrasjes⁷⁰ Edhe brenda vetë vendeve të zhvilluara ka dallime të dukshme në lidhje me shkallën e aplikimit të dënimit me gjobë. Gjohat ditore (të njohura në anglisht si “day fines”) janë një praktikë e përhapur gjerësisht në të drejtën penale të shumicës së vendeve të Evropës perëndimore, si atë Gjermane, Austriake, Franceze, Suedeze, Daneze, Finlandeze⁷¹ etj. Gjithsesi, nga ana tjetër aplikimi i saj i gjerë ka ndeshur në vështirësi në disa vende të tjera të zhvilluara si Anglia, Australia apo Hungaria⁷². Dominimi i aplikimit të dënimit me gjobë ka rënë jo vetëm për shkak të problemeve të manifestuara gjatë aplikimit të tij në praktikë, por edhe si rezultat i shtimit të alternativave të tjera të dënimit⁷³. Nëse para viteve ’70 të shekullit të kaluar burgimi ka qenë alternativa e vetme e dënimit me gjobë, aktualisht gjykata ka një hapësirë më të gjerë zgjedhjeje në përshtatje me rrethanat konkrete të kryerjes së veprës dhe të vetë autorit.

Nga ajo që thamë më lartë del se në nenin 29 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dënimi me gjobë parashikohet si një nga dënimet kryesore për krimet dhe për kundërvajtjet penale. Dënimi me gjobë parashikohet aktualisht në K. Penal shqiptar si dënim i vetëm apo alternativ i dënimit me burgim në 194 nene të pjesës së posaçme të tij. Ka kohe madje mund të themi se prej disa vitesh Shqipëria po përballet me një rëndim të situatës së mbipollimit të burgjeve, e nxitur kjo nga një politikë e ashpër penale dhe nga një frymë politike dhe mediatike pro burgimit.⁷⁴ Kjo situatë ka bërë më imediate çështjen e eksplorimit të alternativave më moderne të burgimit, të cilat jo vetëm na afrojnë me standardet europiane, por përbëjnë dhe një zgjidhje më të zgjuar për çështjet e mbipopullimit të burgjeve, të uljes së kostove ekonomike dhe njerëzore të privimit të lirisë dhe pse jo edhe për një proces më të suksesshëm rehabilitues të personave të dënuar.

Një prej këtyre mundësive të cilat në mjaft vende kanë rezultuar të suksesshme

⁶⁹ Morris & Tonry, 1991, f. 32

⁷⁰ Miethe and Lu, 2005, f. 53

⁷¹ Kantoröicz, 2015, f. 26

⁷² Terance et al, 2005, f. 55

⁷³ Albrecht, 2012, f. 33

⁷⁴ Nikolli, 2015, f. 32.

është dhe sigurimi i një hapësire më të gjerë të aplikimit të dënimit me gjobë. Sipas autorëve Ismet Elezi, Skënder Kaçupi dhe Maksim Haxhia, për nga shtrirja e tij dënimi me gjobë del në plan të parë në raport me të gjitha llojet e tjera të dënimeve. Gjatë këtij punimi do të përqipemi të analizojmë nëse një konstatim i tillë është i bazuar si në aspektin normativ ashtu edhe në atë aplikativ të praktikës gjyqësore. Studimi mbështetet nga njëra anë në një trajtim krahasues të legjislacionit penal shqiptar me disa nga legjislacionet bashkohore europiane në lidhje me dënimin me gjobë dhe nga ana tjetër në një analizë empirike të praktikës gjyqësore shqiptare në përzgjedhjen e këtij lloji dënimi.

Ky kapitull ka për qëllim që të eksplorojë dhe analizojë kuadrin ligjor të dënimit me gjobë në të drejtën penale shqiptare dhe problematikën e ndeshur gjatë aplikimit të tij në praktikë nga gjykatat e vendit. Studimi synon të analizojë përshtatshmërinë e kuadrit ligjor penal shqiptar me standardet europiane në lidhje me dënimin me gjobë dhe nga ana tjetër të eksplorojë tendencën e praktikës gjyqësore në aplikimin e këtij dënimi. Përmes analizimit të dënimit me gjobë në këto dy aspekteve, studimi synon të evidentojë të metat dhe deformimet dhe të përpiket të propozojë disa ndryshime ligjore dhe në jurisprudencës gjyqësore.

Pyetjet kryesore që përshkojnë punimin janë përcaktimi i rolit të dënimit me gjobë në të drejtën tonë penale në raport me dënimet e tjera penale dhe së dyti analizimi nëse kuadri ligjor shqiptar i cili e definon këtë pozitë dhe zbatimi i tij në praktikën gjyqësore, janë në harmoni me standardet europiane dhe me nevojën për një të drejtë penale të arsyeshme dhe humane.

Analizimi dhe shtjellimi i problemit të këtij studimi kalon nëpër një fazë teorike dhe një fazë të analizës empirike. Aspekti teorik i studimit mbështetet përgjithësisht në analizën e germës së ligjit dhe doktrinën vendase të së drejtës penale, politikës penale dhe të penalogjisë, ndërsa për krahasimin e saj janë shqyrtuar legjislacionet penale të disa vendeve evropiane si Gjermanisë, Finlandës, Suedisë, Danimarkës, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Greqisë dhe Maqedonisë. Nga aspekti empirik, studimi mbështetet fillimisht në analizën e të dhënave dytësore të publikuara nga Ministria e Drejtësisë në vjetarët statistikorë 2012 dhe 2013 të cilat japin një informacion më të gjerë mbi aplikimin e dënimit me gjobë në vendin tonë. Për shtjellimin më të thellë të pyetjes kërkimore, është vëzhguar më tej një kampion vendimesh gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë me të pandehur që janë deklaruar fajtorë për kryerjen e disa veprave penale me një përhapje të

gjerë në praktikën gjyqësore shqiptare.

Me qëllim analizimin e diskrecionit gjyqësor në përzgjedhjen e llojit të dënimit me gjobë dhe më pas të masës së saj janë përzgjedhur disa figura veprash penale me një rrezikshmëri jo shumë të lartë shoqërore, të cilat e parashikojnë dënimin me gjobë si alternativë të dënimit me burgim. Veprat penale të tilla janë „Kanosja“, (neni 84 i K. Penal), „Plagosja e lehtë me dashje“, (neni 89), „Vjedhja“, (neni 134/1), „Vjedhja e energjisë elektrike“, (neni 137), „Mashtrimi“, (neni 143/1), „Mashtrimi në sigurime“, (neni 145), „Ushtrimi i palicensuar i lojërave të fatit“, (neni 197), „Ndërtimi i paligjshëm“ (neni 199/a.1), „Prishja e qetësisë publike“, (neni 274), „vetëgjyqësia“ (neni 277), „Mbajtja pa leje e armëve luftarake“, (neni 278/2), dhe „Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt“, parashikuar nga neni 291/1 i K. Penal.

Për shkak të aktualizimit të këtij studimi përzgjedhja e këtyre vendimeve është shtrirë për vitet 2012, 2013, dhe 2014. Kampioni i vendimeve është marrë nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nisur nga fakti se ajo është gjykata më e madhe në vend dhe që shqyrton rreth 25 % të çështjeve penale në rang vendi. Kështu gjatë vitit 2012, nga 8 679 të dënuar në shkallë vendi, 2143 ose 24.7 % janë dënuar vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndërsa në vitin 2013 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë dënuar 2178 persona, nga 8 578 persona në rang vendi ose 25.4% ⁷⁵ Gjykata e Tiranës është poashtu gjykata më përfaqësuese nga pikëpamja e origjinës krahinore, formimit akademik dhe kulturor të trupës gjyqësore (elementë të cilët kanë një peshë në subjektivizmin gjyqësor gjatë procesit të individualizimit të dënimit). Kampioni i vendimeve të marra ka një shkallë të lartë përfaqësimi dhe për disa vepra penale me një frekuencë jo shumë të lartë ka një mbulim 100% të popullatës së tyre. Në këtë studim janë analizuar 400 vendime gjyqësore të kësaj gjykate, përkatësisht 200 krime dhe 200 kundërvajtje dhe përzgjedhja e tyre (për ato vepra penale për të cilat kampioni është më i vogël se popullata) është bërë tërësisht në mënyrë rastësore sipas renditjes që ato kanë në faqen zyrtare në ueb të Gjykatës së Tiranës.

Dënimi me gjobë sipas Kodit Penal shqiptar

Në pjesën e përgjithshme të kodit të ri penal shqiptar të vitit 1995, në kreun V të tij janë parashikuar tërësia e llojeve të dënimeve, i njohur në terminologjinë juridike si

⁷⁵Ministria e drejtësisë, 2013; f. 55

sistemi i dënimeve. Gjithsej për sistemin e dënimeve janë parashikuar 17 nene duke filluar nga neni 29 deri në nenin 46. Nga pikëpamja formalo strukturore, në kodin e ri penal janë ruajtur po ato kritere që kanë qenë në themel të sistemit të dënimeve në kodin penal të mëparshëm, pra ndarja në dy grupime të mëdha klasike, në atë të dënimeve kryesore dhe të dënimeve plotësuese.⁷⁶ Dënimet kryesore nga ana e tyre ndahen për krime dhe për kundravajtje penale.

Paragrafi i parë i nenit 29 të K. Penal parashikon dënimet kryesore për krimet, ndërsa në paragrafin e dytë parashikohen dënimet kryesore për kundërvajtjet penale. Sipas nenit 29 të kodit penal, dënimi me gjobë dhe ai me burgim janë dy dënimet kryesore të parashikuara si për krimet ashtu edhe për kundërvajtjet penale.

Me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, në nenin 29 të K. Penal Kuvendi shtoi paragrafin e tretë, duke parashikuar se dënimi me burgim dhe gjobë mund të caktohen edhe bashkërisht, kur parashikohet në dispozitat përkatëse të këtij Kodi. Ky ishte një përjashtim nga rregulli tradicional dhe që karakterizonte vetë dënimet kryesore, pra caktimi vetëm i një dënimi kryesor për një vepër penale të kryer ⁷⁷Pas shtimit të këtij paragrafi, këto ndryshime parimore u reflektuan edhe në pjesën e posaçme të K. Penal, ku në një numër dispozitash penale dënimi me gjobë u parashikua të jepej nga gjykata krahas dënimit burgim. Pas disa ndryshimeve ligjore, në vitin 2012 numri i dispozitave penale të pjesës së posaçme që i parashikonin njëkohësisht të dy llojet e dënimeve kryesore arriti në 49 nene (konkretisht në nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 114/b, 117, 124/a, 124/b, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 190, 191, 197/a, 206/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331 të K. Penal).

Pas kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë për kontroll incidental të paragrafit të tretë të nenit 29 i K. Penal, Gjykata Kushtetuese me Vendimin Nr. 47, datë 26.07.2012 e ka pranuar këtë kërkesë, duke e shfuqizuar këtë dispozitë si në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës. Në arsyetimin e saj Gjykata Kushtetuese shprehet se parashikimi a priori njëkohësisht i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla si falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit

⁷⁶ Elezi, Kaçupi, & Haxhia, 2013, fq 223

⁷⁷ Muçi, 2012, p. 270.

të dënimit e si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.

Shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i paragrafit të tretë të nenit 29 dhe të dënimit me gjobë në nenet 190 dhe 191 të pjesës së posaçme të K. Penal, u pasua me shfuqimin në nenet 83/a, 83/b, 109, 109/b, 110/a, 124/a, 128/b, 135, 143/b, 164/a, 164/b, 186, 189, 197/a, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 259, 259/a, 260, 287, 287/a, 287/b, 298, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 326, 326/a dhe 331, të pjesës që parashikon si dënim kryesor edhe dënimin me gjobë, krahas dënimit me burgim.

Dispozita kryesore e K. Penal e cila detajon dënimin me gjobë dhe mënyrën e ekzekutimit të tij është neni 34 i tij. Kjo është një dispozitë e gjatë përshkruese, e cila ka pësuar ndryshime të shumta që nga viti 1995 dhe aktualisht është e përbërë nga 13 paragrafë. Dënimi me gjobë konsiston në pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit që aktualisht për kryerjen e një krimi varion nga 100 mijë gjer në 10 milionë lekë ndërsa për kryerjen e një kundërvajtje penale, nga 50 mijë gjer në 3 milionë lekë. Në reflektim të vendimit nr 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, caktimi i dënimit me gjobë krahas dënimit me burgim u kufizua edhe për rastet e kryerjes së krimeve për motive fitimi të pasurive. Sipas formulimit që paragrafi i pestë i nenit 34 mori pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013 për rastet e kryerjes së krimeve për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, gjykata vendos sipas nenit 36 të këtij Kodi, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale dhe vetëm në mungesë të tyre, vendos dënim me gjobë në masën nga 100 mijë deri në 5 milion lekë.

Një ndryshim themeltar po ashtu interesant i kësaj dispozite është sanksionimi i detyrimit të Gjykatës që të hetojë rreth aftësisë paguese të personit përpara se të caktojë dënimin me gjobë. Aftësia paguese sipas këtij rregullimi përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to. Megjithëse ky paragraf vlerësohet si inovativ dhe i arsyeshëm nga aspekti i dhënies së një vendimi të bazuar gjyqësor, ai nxjerr në pah disa probleme procedurale që kanë të bëjnë me pozicionin pasiv të gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, me cenimin e paanësisë së saj në rast të kalimit të saj të përhershëm në një rol aktiv dhe së fundmi në shtyrjen e gjyqeve

penale për të hetuar rrethana të tilla.

Na del një problem i madh praktik i implementimit të dënimit me gjobë dhe prej saj i humbjes së efektit ndëshkues, parandalues dhe edukues të këtij lloji dënimi, ka qenë ekzekutimi i tij. Përveç elementëve objektivë siç është pamundësia paguese e të dënuarit, kjo ineffiçensë është nxitur edhe nga hapësirat ligjore, të metat e shërbimit përmbartimor dhe një mungesë zhdërvjelltësie në ndjekjen në një kohë të shkurtër të këtyre procedurave nga prokuroria dhe gjykata. Një rol tejet negativ në kulturën e moszekutimit të gjobave penale ka luajtur edhe shpeshësia e nxjerrjes së ligjeve amnistuese, të cilat kanë falur pjesën më të madhe të gjobave të caktuara nga gjykatat. Në një hapësirë prej 16 muajsh Kuvendi ka miratuar dy ligje për amnisti penale.⁷⁸

Në Shqipëri pjesë e ngërçit ligjor në ekzekutimin e gjobave penale ka qenë dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 01.06.2011, i cili ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën, paragrafin 8 të nenit 34 të Kodit Penal, i cili parashikonte zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur 5 mijë lekë për një ditë burgim, në rastin kur gjoba e caktuar nga gjykata nuk paguhej në afatin e caktuar. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese arsyeton se konvertimi i dënimit me gjobë në dënimin me burgim është në përputhje me funksionin riedukativ të dënimit, në rastin kur i dënuari me vullnetin e tij të lirë refuzon t'i bindet vendimit gjyqësor që e detyron të paguajë gjobën. Në të kundërt, kur personi është në pamundësi objektive për të shlyer gjobën nisur nga kushtet ekonomike të të dënuarit (pra nuk varet nga ana subjektive e autorit), konvertimi i dënimit me gjobë në burgim, do të shkaktonte një trajtim të diferencuar të shtetasve vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës. Nga ajo që thamë më lartë, del se pas këtij vendimi me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012 u riformulua edhe ky paragraf duke parashikuar dy faza të ndjekjes së ekzekutimit të dënimit me gjobë Sipas pikës 9 të këtij neni kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjoba, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

a. shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;

b. kryerjen e një pune me interes publik.

⁷⁸ Ligji nr. 107/2012 dhe ligji nr. 22/2014.

Në Shqipëri nga mënyra se si është formuluar kjo dispozitë dhe nisur nga arsyet që e kanë shtyrë legjislatorin në këtë riformulim, duket se Gjykata është e detyruar që të vendosë sipas njërës prej alternativave të kërkuara nga vetë i dënuari. Ky rregullim parashikon se vetëm në fazën e dytë, pra nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, atëherë gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim. Ky parashikim i ri e ka zgjidhur në një masë të madhe çështjen e mosburgosjes së shtetasve për shkak të paafsisë së tyre pagueuse, megjithëse përsëri në disa raste më të paketa mund të ngrihen përsëri pretendime për antikushetueshmëri të kësaj norme.

Caktimi i dënimit me gjobë nga Gjykatat shqiptare

Në këtë seksion do të përpiqemi që përmes metodave sasimore të paraqesim një panoramë të dënimit me gjobë sipas praktikës gjyqësore të vendit tonë. Gjatë vitit 2012 nga totali i të dënuarve për krime dhe kundërvajtje penale vetëm 3114 apo 35.8% janë dënuar me gjobë (Ministria e Drejtësisë, 2013. f. 62), ndërsa në vitin 2013 ku numër është ulur në 2357 të dënuar apo 27.5 % (Ministria e Drejtësisë, 2014. f. 63). Raporti i të dënuarve me gjobë për kundërvajtjet është shumë më i lartë se për krimet. Kështu në vitin 2012 rreth 77.2 % e kundërvajtësve janë dënuar me gjobë, ndërkohë që për krimet janë dënuar me gjobë vetëm 21.5 %. Në vitin 2013 të dënuarit me gjobë për kundërvajtje zënë 60 % ndërsa për krime vetëm 14.8 %. Nisur nga ashpërsimi i politikës penale për disa vepra penale me një frekuencë të lartë për të cilat dënimi me gjobë është hequr (si vjedhja e energjisë elektrike, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, apo falsifikimet) dhe nga një frymë e dukshme pro burgimit, në vitin 2014 dhe më tej në vitin 2015 pesha e dënimit me gjobë do të jetë akoma më e ulët. Megjithëse akoma për këtë periudhë nuk ka të dhëna statistikore kombëtare të Ministrisë së Drejtësisë, nga analiza vjetore e vitit 2014 e gjykatës së Tiranës (2015; f. 23) vërehet se dënimi me gjobë për këtë vit zë vetëm 13.4% të totalit, ndërsa nga ajo e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (2015; f. 21) është 17.7 %.

Për një analizë më të thelluar të jurisprudencës gjyqësore në lidhje me aplikimin e dënimit me gjobë kemi kryer një vëzhgim të drejtpërdrejtë të praktikës gjyqësore. Në kryerjen e këtij vëzhgimi jemi fokusuar vetëm në disa vepra penale të cilat në vitet e fundit kanë patur një frekuencë shumë të lartë gjyqësore. Kështu nga 334 nene që ka aktualisht në fuqi pjesa e posaçme e kodit penal, në vitin 2012 vetëm sipas 15 neneve (më saktë

paragrafëve) janë dënuar 5096 persona apo 58.7 % e totalit të dënuarve dhe në vitin 2013 vetëm sipas 20 neneve (paragrafëve) të K. Penal janë dënuar 4477 persona, apo 55.7 % e totalit.

Nga analizimi llojit dhe i masave të dënimit në kampionin prej 400 vendimesh gjyqësore rezultoi se ato paraqiten si në tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1. Lloji dhe masat e dënimit të caktuara nga Gjykata Tiranë.

200 Krime					200 Kundërvajtje				
40 të dënuar me gjobë ose 20 %					136 të dënuar me gjobë ose 68%				
Mbi 500 mijë lekë	301- 500 mijë lekë	201- 300 mijë lekë	151- 200 mijë lekë	101- 150 mijë lekë	Mbi 300 mijë lekë	151- 300 mijë lekë	101- 150 mijë lekë	76- 100 mijë lekë	50- 75 mijë lekë
2 ose 1%	4 ose 10 %	8 ose 20 %	5 ose 12.5 %	21 ose 52.5 %	2 ose 1.5 %	26 ose 19.1 %	44 ose 32.3 %	26 ose 19.1 %	38 ose 30 %

Siç vërehet, nga kampioni i 200 vendimeve të dënimit për kundërvajtje penale 68 % e tyre janë dënuar me gjobë. Nga ana tjetër nga kampioni i vendimeve të dënimit për krime rezultoi se vetëm 20 % e të pandehurve janë dënuar me gjobë, ndërsa pjesa tjetër janë dënuar me burgim (brenda të cilëve përfshihet dhe dënimet alternative).

Përveç të dhënave të paraqitura në këtë tabelë, vlen të përmenden edhe disa gjetje domethënëse që kanë të bëjnë me tipologjinë e veprave të kampionuara. Kështu për kundërvajtjet ndeshet një aplikim i dënimit me gjobë në 98 % të rasteve për nenin 197 të K. Penal, 68% për nenin 89 dhe vetëm 44 % për nenin 84 të K. Penal. Nga ana tjetër për kampionin e krimeve rezultoi se dënimi me gjobë është aplikuar vetëm 10 % për “Vjedhje” (nenin 134/1 të K. Penal), ndërkohë që për “Mashtrim” (neni 143/1), “Mashtrim në sigurime” (neni 145), apo “Shkatërrimi i pronës” (neni 150) është aplikuar në mbi 30 %. Shpjegimi logjik i një diferencimi të tillë (për vepra të ngjashme me objekt grupor pasurinë) vështirësohet edhe më tej po të mbahet në konsideratë fakti se nga kampioni i vendimeve rezulton se vlera mesatare e pasurisë së humbur nga vjedhja është më e vogël

se e pasurisë së humbur/dëmtuar nga tre veprat e tjera. Me gjasë, i vetmi justifikim për këtë diferencë është përhapja disa herë më e lartë e vjedhjes se e veprave të tjera kundër pasurisë.

Më tej nga ky vëzhgim rezultoi se 39 % të të dënuarve me gjobë për kundërvajtje janë dënuar nga 50.000 deri në 100.000 lekë, ndërsa 65 % të të dënuarve për krime janë dënuar nga 100.000-200.000 lekë. Megjithëse në shumicën e rasteve të analizuara në kampion, masa e dënimit me gjobë është shumë më afër minimumit sesa maksimumit të parashikuar nga neni 34 i K. Penal (maksimumi për kundërvajtje është 3 milion lekë ndërsa për kundërvajtje 10 milionë lekë), në krahasim në nivelin ekonomik mesatar të shoqërisë shqiptare, në mjaft raste është i lartë. Nga të dhënat e INSTAT, në Shqipëri (2014) paga mesatare mujore e një të punësuarit në administratën publike në vitin 2013 ka qenë 52 000 lekë ose 371 euro, ndërkohë që për familjet në nevojë (të cilët janë një kontingjent i shumë veprave penale, si vjedhja, vjedhja e energjisë elektrike etj.) pagesa maksimale e ndihmës ekonomike për një familje ka është maksimumi 7000 lekë në muaj⁷⁹).

Nga ana tjetër në Shqipëri nuk është bërë ndonjë studim i detajuar në lidhje me kostot ditore të burgimit të një personi, mirëpo sipas një vlerësimi të OSCE kostoja mujore e një të burgosuri në Shqipëri është 439 euro në muaj apo 5300 euro në vit (Raunig, 2014). Këto kosto marrin parasysh vetëm shpenzimet që kanë në vit institucionet penitensiare në raport me numrin e të burgosurve, por nuk marrin në konsideratë kosto të tjera shtesë si shpenzimet qeveritare apo donacionet për ngritjen e burgjeve të reja apo riparimin dhe përmiresimin e atyre ekzistues, shpenzimet që kryejnë familjet për të vizituar dhe kujdesur për të afërmit e tyre të burgosur, mosmarrja e të ardhurave që i burgosuri merrte kur punonte jashtë burgut, rënia e aftësive profesionale të të burgosurve etj. Nga ana tjetër megjithëse shuma prej 5300 euro në vit është shumë e vogël në krahasim me kostot e vendeve të zhvilluara perëndimore, përsëri për ekonominë e brishtë shqiptare këto janë kosto të konsiderueshme po të mbahet parasysh se GDP për frymë në vitin 2013 ishte vetëm 4,652 \$ (Eorld Bank, 2014), apo rreth 3520 euro në vit.

Është e paarsyeshme që minimumi i dënimit me gjobë sipas legjislacionit shqiptar të jetë (sa mesatarja e pagës bruto mujore të një zyrtari) dhe në vlerë absolute disa herë më i lartë se i Greqisë, Italisë, Finlandës, Francës apo Gjermanisë për të cilët siç u përmend

⁷⁹ V.K.M. nr. 787, 2005

më lart varion nga 1 euro deri në maksimumin e të ardhurave ditore të të pandehurit. Si ilustrim të nivelit të lartë të minimumit të gjobës penale në vendin tonë mund të përmendim se në vitin 2003 në Itali 70 % të të dënuarve me gjobë për krime kanë marrë një gjobë nën 1000 euro ndërsa 82 % nën këtë shumë për kundërvajtje penale.⁸⁰

